Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M1-2017

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga Botimet IDEA sh.p.k.

P Ë R M B A J T J A

HYRJE 7

SQARIME 8

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2017 9

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR 16
1.1 Rreziku sistemik 19

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE 21
2.1 Zhvillimet në tregjet financiare dhe të lëndëve të para 24

3 ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND 27

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE 29
4.1 Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve 29
4.2 Tregu i pasurive të paluajtshme 36

5. TREGJET FINANCIARE 40
5.1 Tregu i letrave me vlerë 40
5.2 Tregu ndërbankar 42
5.3 Tregu i këmbimeve valutore 42

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE 44

7. SISTEMI FINANCIAR 46
7.1 Zhvillimet në sektorin jobankar 47
7.2 Vlerësimi i rreziqeve dhe ekspozimeve të sektorit jobankar 50

8. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR 52
8.1 Ecuria e aktivitetit bankar 52
8.2 Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve 54
8.3 Zhvillimet në kreditim 56
8.4 Depozitat dhe rreziku i likuiditetit 67
8.5 Rreziqet e tregut dhe ai operacional 72
8.6 Rezultati financiar dhe eficienca e burimeve 75
8.7 Kapitalizimi i veprimtarisë 77

9. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS 80
9.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve makroekonomike 80
9.2 Prova e rezistencës së likuiditetit 82

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1.1.	*Përbërësit e hartës së stabilitetit financiar*	*18*
Hapësirë informuese 2.1.	*Zhvillimet në grupet bankare të huaja që operojnë në Shqipëri*	*25*
Hapësirë informuese 4.1.	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve*	*32*
Hapësirë informuese 4.2.	*Rezultatet e vrojtimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve*	*35*
Hapësirë informuese 4.3.	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017*	*38*
Hapësirë informuese 8.1.	*Sektori bankar dhe kredia e pambrojtur në valutë*	*59*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2. Zhvillimet ndërkombëtare

Tabela 2.1.	*Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën*	*23*
Tabela 2.2.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor*	*23*
Tabelë 2.3.	*Zhvillimet në grupet e huaja bankare që operojnë në Shqipëri*	*25*

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Tabela 4.1.	*Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar*	*30*

7. Sistemi financiar

Tabelë 7.1.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite*	*47*

8. Zhvillimet në sektorin bankar

Tabelë 8.1.	*Struktura e bilancit të bankave, qershor 2017*	*53*
Tabelë 8.2.	*Ecuria e kredisë*	*56*
Tabelë 8.4.	*Tregues kryesorë të depozitave në sektorin bankar*	*68*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1. Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve kryesore të stabilitetit financiar

Grafik 1.1	Harta e stabilitetit financiar	17
Grafik 1.2	Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik	19
Grafik 1.3	Indeksi i Stresit Financiar	19
Grafik 1.4	Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike	20

2. Zhvillimet ndërkombëtare

Grafik 2.1	Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve	24
Grafik 2.2	Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera	24

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Grafik 4.1	Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve, miliardë lekë	30
Grafik 4.2	Struktura e kredisë për individët sipas afatit të maturimit dhe monedhës	31
Grafik 4.3	Ndryshimi vjetor i raportit të kredive me probleme për individët, pikë përqindje	31
Grafik 4.4	Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit dhe monedhës	33
Grafik 4.5	Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë	34
Grafik 4.6	Ndryshimi vjetor i raportit të kredive me probleme për bizneset, në pikë përqindjeje	34
Grafik 4.7	Kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme dhe kosto e pagesës së kredisë	37
Grafik 4.8	Raporti i kredive me probleme	37

5. Tregjet Financiare

Grafik 5.1	Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë, në përqindje	40
Grafik 5.2	Përbërja e borxhit të emetuar gjatë 2015-6M1 2017	40
Grafik 5.3	Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6M I - 2017	41
Grafik 5.4	Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6M I - 2017	41
Grafik 5.5	Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e bonove të thesarit në tregun primar	41
Grafik 5.6	Vëllimi dhe norma mesatare e obligacioneve në tregun primar	41
Grafik 5.7	Huamarrja e brendshme në euro	42
Grafik 5.8	Normat e interesit në tregun ndërbankar	42
Grafik 5.9	Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor	43

6. Zhvillimet në sistemet e pagesave

Grafik 6.1	Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH për gjashtëmujorin e parë 2016-2017	44
Grafik 6.2	Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë	45

7. Sistemi Financiar

Grafik 7.1	Rritja vjetore e aktiveve të segmenteve përbërës të sistemit financiar.	47
Grafik 7.2	Struktura e institucioneve financiare jobanka sipas aktivitetit që kryejnë	47
Grafik 7.3	Struktura e aktiveve të institucioneve financiare jobanka	48
Grafik 7.4	Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit	48
Grafik 7.5	Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimit	48
Grafik 7.6	Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve	49
Grafik 7.7	Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve private suplementare	50
Grafik 7.8	Ekspozimi i institucioneve kryesore jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre	50
Grafik 7.9	Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në titujt e qeverisë, ndaj totalit të aktiveve të tyre	50

8. Zhvillimet në sektorin bankar

Grafik 8.1	Treguesi Herfindahl për produktet kryesore bankare	54
Grafik 8.2	Kontributi i zërave në rritjen vjetore të aktiveve me jorezidentët, pp	55
Grafik 8.3	Përbërësit e detyrimeve jorezidente	55

Grafik 8.4	*Ecuria e kredisë sipas monedhave, rritje vjetore*	*57*
Grafik 8.5	*Ecuria e kredisë sipas afatit, rritje vjetore*	*57*
Grafik 8.6	*Ecuria e kredisë sipas qëllimit të përdorimit, rritje vjetore dhe ndryshimi mujor i stokut*	*58*
Grafik 8.7	*Ecuria e kredisë për jorezidentët*	*58*
Grafik 8.8	*Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë*	*59*
Grafik 8.9	*Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas subjekteve, në përqindje*	*59*
Grafik 8.10	*Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj*	*60*
Grafik 8.11	*Kredia e pambrojtur në valutë (jo për pasuri të paluajtshme)*	*60*
Grafik 8.12	*Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit*	*61*
Grafik 8.13	*Shpërndarja e kredisë së re sipas afatit të maturimit dhe monedhës*	*62*
Grafik 8.14	*Raporti i kredive me probleme*	*63*
Grafik 8.15	*Kontributi në ndryshimin gjashtëmujor të stokut të kredive me probleme*	*63*
Grafik 8.16	*Struktura e kredive me probleme*	*63*
Grafik 8.17	*Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare*	*63*
Grafik 8.18	*Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar*	*64*
Grafik 8.19	*Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*	*65*
Grafik 8.20	*Ecuria e cilësisë së kredisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit dhe ecuria e kredive me probleme për subjektet jorezidente*	*65*
Grafik 8.21	*Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit*	*66*
Grafik 8.22	*Ndryshimi vjetor në raportet e mbulimit për bankat*	*66*
Grafik 8.23	*Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas kolateraleve*	*67*
Grafik 8.24	*Kontributi në ecurinë e depozitave*	*69*
Grafik 8.25	*Ecuria e depozitave sipas llojit*	*69*
Grafik 8.26	*Përbërja e depozitave të reja me afat sipas monedhës dhe afatit të maturimit, flukset gjashtëmujore*	*70*
Grafik 8.27	*Tregues të likuiditetit*	*71*
Grafik 8.28	*Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*	*71*
Grafik 8.29	*Maturimi mesatar i mbetur*	*71*
Grafik 8.30	*Pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë*	*72*
Grafik 8.31	*Mospërputhja valutore sipas përbërësve*	*73*
Grafik 8.32	*Mospërputhja valutore sipas monedhave*	*73*
Grafik 8.33	*Mospërputhja valutore sipas monedhave dhe grupeve*	*73*
Grafik 8.34	*Mospërputhja valutore, sipas grupeve*	*73*
Grafik 8.35	*Spread-i i normave të interesit sipas monedhave*	*74*
Grafik 8.36	*Kërkesa për kapital për rrezikun operacional*	*75*
Grafik 8.37	*Përbërësit e rezultatit financiar*	*75*
Grafik 8.38	*ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit*	*75*
Grafik 8.39	*Marzhi neto nga interesi*	*76*
Grafik 8.40	*Shpenzimet për provigjione*	*76*
Grafik 8.41	*Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë*	*77*
Grafik 8.42	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit*	*77*
Grafik 8.43	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit*	*78*
Grafik 8.44	*Shpërndarja e aktiveve të sektorit sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*78*
Grafik 8.45	*Koeficientët e ponderimit dhe madhësia e klasave kryesore të portofolit të kredisë*	*78*
Grafik 8.46	*Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas madhësisë së aktivitetit dhe origjinës së kapitalit*	*79*
Grafik 8.47	*Treguesi i levës financiare, në herë*	*79*

9. Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas ushtrimit të provës së rezistencës

Grafik 9.1	*Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës*	*80*
Grafik 9.2	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës*	*82*

HYRJE

Ky është numri i 18-të i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat përballet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'iu dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila sipas kërkesës së ligjit duhet të publikohet çdo gjashtë muaj.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat e paraqitura përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe deri në 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara dhe ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve specifike, është vlerësuar gjendja financiare e bizneseve dhe e individëve dhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Në raport janë përfshirë, në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës, i cili ka përfshirë edhe skenarë të stresit të likuiditetit.

SQARIME

Në fund të muajit qershor 2017, bankat e sektorit bankar shqiptar ndahen sipas madhësisë së aktivitetit në:

- banka të Grupit 1 (secila zotëron 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Veneto Banka sh.a., Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a., Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka e Kredititi të Shqipërisë sh.a..
  Këto banka përbëjnë rreth 4.7% të totalit të aktiveve të sektorit.

- banka të Grupit 2 (secila zotëron 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Procredit sh.a., Banka NBG Albania sh.a., Banka Société Générale Albania sh.a., Banka Alpha Albania sh.a., Banka Union sh.a., Banka Tirana sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a..
  Këto banka përbëjnë rreth 27.2% të totalit të aktiveve të sekt orit.

- banka të Grupit 3 (secila zotëron mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a.
  Këto banka përbëjnë rreth 68.4% të totalit të aktiveve të sektorit.

Në fund të muajit qershor 2017, sipas origjinës së kapitalit, bankat e sektorit bankar shqiptar grupohen në:

- me kapital të huaj[1]: Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. – Shqipëri, Veneto Banka sh.a. (Italì); Banka Alpha Albania sh.a., Banka Tirana sh.a., Banka NBG Albania sh.a. (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka Société Générale Albania sh.a. (Francë); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari); Banka Ndërkombëtare Tregtare sh.a. (Malajzi); Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (Banka Islamike e Zhvillimit - Arabia Saudite); Banka e Kredititi të Shqipërisë sh.a. (Kuvajt); Këto banka përbëjnë rreth 82.6% të totalit të aktiveve të sektorit.

- me kapital shqiptar: Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a.. Këto banka përbëjnë rreth 17.4% të totalit të aktiveve të sektorit.

Në fund të muajit qershor 2017, shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit evidenton Banka Kombëtare Tregtare, me degën e saj në Kosovë.

[1] *Sipas origjinës së kapitalit, kur kapitali i huaj përbën më shumë së 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2017

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me zhvillimet ekonomike të jashtme, të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si edhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë e tij. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e tij.

Banka e Shqipërisë vlerëson që veprimtaria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar në përgjithësi, u paraqit e qëndrueshme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, dhe aftësia e tij për të përballuar rreziqet e veprimtarisë është e mirë.

Në tërësi, ecuria e treguesve makroekonomikë dhe zhvillimet në mjedisin e përgjithshëm ekonomik, mbështetën më mirë veprimtarinë e sistemit financiar. Në sektorin bankar, treguesit e performancës financiare, të kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë, përgjithësisht u përmirësuan. Megjithatë, analiza e faktorëve përcaktues dhe ushtrimet e provës së rezistencës sugjerojnë nevojën për monitorimin e ecurisë së këtyre treguesve përgjatë kohës. Zhvillimet në sektorin bankar gjatë periudhës evidentuan përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së kredisë dhe dëshmuan rëndësinë e vijimit të këtij procesi.

Zhvillimet në mjedisin ekonomik dhe financiar

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, zhvillimet në **ekonominë botërore** kanë qenë përgjithësisht pozitive. Rritja ekonomike është përshpejtuar, mbështetur kryesisht nga kushtet e favorshme të financimit dhe vijimi i politikave stimuluese, si në vendet e zhvilluara ashtu edhe tek një pjesë e vendeve në zhvillim. Qëndrueshmëria e çmimit të naftës ka ndikuar në uljen e ndikimit

negativ që solli rënia e mëparshme e tij mbi vendet eksportuese. Në Eurozonë, rritja ekonomike është shtrirë tek një numër më i madh vendesh anëtare, dhe është mbështetur nga rritja e konsumit privat si rezultat i përmirësimit të kushteve në tregun e punës, rritjes së të ardhurave dhe qëndrueshmërisë së kreditimit veçanërisht për familjet. Në sektorin bankar evropian, nevoja për uljen e kredive me probleme mbetet e lartë, pavarësisht progresit që është bërë në këtë drejtim. Presionet inflacioniste përgjithësisht mbeten nën nivelin e synuar nga bankat qendrore. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, zhvillimet kanë qenë të ngjashme me ato të ekonomisë botërore. Gjatë periudhës, vendet e rajonit kanë shënuar rritje më të shpejtë ekonomike kryesisht të mbështetur nga kërkesa e brendshme në vijim edhe të uljes së normës së papunësisë. Kreditimi vijon të jetë përgjithësisht i dobët dhe i përqendruar kryesisht tek familjet, megjithë vijimin e kushteve monetare lehtësuese dhe përmirësimin gradual të cilësisë së aktiveve. Si rezultat, presionet inflacioniste gjatë periudhës kanë qenë të përmbajtura. Në vijim të politikave stimuluese financiare dhe reformave të tjera ekonomike, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) parashikon që rritja ekonomike botërore të jetë rreth 3.5% - 3.6% në periudhën 2017-2018, me kontribut pozitiv nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Normalizimi i politikës monetare në vendet e zhvilluara dhe mundësia e shtimit të luhatshmërisë në tregje, përbën aktualisht rrezikun kryesor mbi perspektivën e ekonomisë globale.

Në vendin tonë, ritmi vjetor i rritjes ekonomike u ngjit në 3.94% në fund të tremujorit të parë të vitit. Në rritjen ekonomike kontribuan sektorët e shërbimeve, të prodhimit dhe të bujqësisë, dhe spikatën degët e tregtisë, ndërtimit, transportit dhe industrisë. Rritja e kërkesës agregate u mbështet nga zgjerimi i konsumit final të popullatës (me peshën kryesore), rritja e konsumit të qeverisë dhe formimi i kapitalit fiks. Gjithashtu, në zgjerimin e kërkesës ka kontribuar pozitivisht edhe ngushtimi i deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, i shkaktuar kryesisht nga zgjerimi i tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve. Në tregun e punës, norma e papunësisë shënoi nivelin 14.2%, pothuaj e pandryshuar prej fundit të vitit 2016 dhe gati 2.4 pikë përqindjeje më e ulët se tremujorin e parë të vitit të kaluar. Gjatë periudhës, në vijim të presioneve të përmbajtura të inflacionit, politika monetare ka mbetur lehtësuese, duke mbështetur zgjerimin e aktivitetit ekonomik. Teprica pozitive e buxhetit reflektoi vijimin e procesit të konsolidimit fiskal. Por vlera e suficitit buxhetor ishte më e ulët se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, si rezultat i ritmit më të lartë të realizimit të shpenzimeve në krahasim me atë të mbledhjes së të ardhurave.

Në tregun financiar vendas, gjatë periudhës u konstatua një rritje e lehtë e normave mesatare të interesit për investimet në titujt e borxhit të qeverisë. Në këtë ecuri, kontribuan kryesisht titujt e borxhit afatshkurtër, për të cilët niveli dhe rritja e emetimeve ka qenë më e lartë sesa për titujt e borxhit afatgjatë. Pjesëmarrja e investitorëve në ankandet e titujve të borxhit të qeverisë ka qenë e qëndrueshme, dhe preferenca e tyre shfaqet më e lartë për titujt me afate më të gjata maturimi. Në tregun ndërbankar, bankat kanë tregtuar përgjithësisht në vëllime më të ulëta, me norma interesi që kanë qenë vazhdimisht nën ose pranë

nivelit të normës bazë të interesit, duke reflektuar një situatë të qëndrueshme të likuiditetit. Në tregun e këmbimeve të monedhave, leku u mbiçmua ndaj monedhës evropiane dhe dollarit amerikan. Kjo ecuri ka reflektuar zhvillimet më pozitive në bilancin e pagesave të vendit me botën. Në tregun e pasurive të paluajtshme, të dhënat dhe vrojtimet tregojnë për një rënie të çmimit të banesave, kryesisht në vijim të rritjes së kapaciteteve të strehimit. Në këtë treg, pritshmëritë e operatorëve për ecurinë e çmimit të pasurive të paluajtshme mbeten pozitive.

Gjatë periudhës, pozicioni kreditor[2] ***i individëve*** dhe pozicioni debitor ***i bizneseve***, pësuan rënie. Për individët, efekti ka ardhur nga rritja e kreditimit në lekë dhe rënia e depozitave kryesisht në valutë, ndërsa për bizneset efekti ka ardhur nga rënia e kreditimit në valutë me ritme më të shpejta se rënia e depozitave. Kredia për individët u rrit me 2.8% gjatë periudhës. Pothuajse e gjithë rritja ka ardhur nga rritja e kredisë në lekë për subjektet rezidente. Kredia për bizneset është tkurrur gjatë periudhës me 2.3%, ku kontributin në rënie e dha kredia për subjektet rezidente, ndërkohë që kredia për bizneset jorezidente shënoi rritje. Cilësia e kredisë, si për individët ashtu edhe për bizneset është përmirësuar. Gjatë periudhës, vlerat e tepricave të kredisë dhe të depozitave të subjekteve pranë sektorit bankar janë ndikuar në mënyrë të ndjeshme, në kahun rënës, nga mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore.

Pesha e veprimtarisë së ***sistemit financiar*** ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) vlerësohet të ketë zbritur në 101.9% në fund të periudhës, por treguesit kryesorë financiarë përgjithësisht u përmirësuan. Në rënien e peshës së sistemit financiar, ndikoi kryesisht rënia e peshës së aktivitetit bankar, i cili zbriti në 91.9% të PBB-së. Sektori jobankar ka ruajtur peshën ndaj PBB-së, dhe në veprimtarinë e tij kanë kontribuar pozitivisht institucionet financiare jobanka, fondet private të pensioneve dhe fondet e investimeve. Në veprimtarinë e sektorit bankar, e cila u tkurr me 1% gjatë periudhës, ndryshimin më të madh në aktiv të bilancit e shfaqën veprimet me titujt, kryesisht me ato jorezidente (rënie), veprimet me thesarin (rënie) dhe veprimet ndërbankare, kryesisht në formën e depozitave me subjektet jorezidente (rritje). Në krahun e pasivit, ndryshimin më të madh e treguan depozitat e klientëve (rënie) dhe kapitali (rritje). Në krahasim me një vit më parë, aktiviteti i sektorit bankar është rritur me 4.8%, ku depozitat janë rritur me 3.5%, teprica e kredisë shfaqet e pandryshuar dhe pozicioni kreditor neto me jorezidentët është rritur me 11.7%. Ecuria e tepricës së kredisë reflekton procesin e largimit të kredive të humbura nga bilanci i sektorit bankar, dhe një kërkesë ende të brishtë për kredi, siç reflektohet edhe nga vrojtimet përkatëse të gjendjes financiare të individëve dhe të bizneseve. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar në sektorin jobankar vlerësohet i ulët, ndërkohë që qëndrueshmëria e sektorit bankar mbetet një faktor me rëndësi kritike për aktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar.

[2] *Diferenca midis depozitave dhe kredisë së individëve në sektorin bankar.*

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë

Në lidhje me rreziqet e veprimtarisë me të cilat përballet sektori bankar, Banka e Shqipërisë vlerëson si më poshtë:

a) *Rreziku i kreditit shënoi ulje të ndjeshme gjatë periudhës dhe në krahasim me një vit më parë.* Kreditë me probleme ranë me 15.2% gjatë periudhës dhe me 22% krahasuar me një vit më parë. Si rezultat, raporti i kredive me probleme zbriti me 2.7 pikë përqindje gjatë periudhës, në nivelin 15.6%. Në uljen e kredive me probleme kanë ndikuar veprimet e bankave për mbledhjen, ristrukturimin dhe largimin e tyre (të kredive të humbura) nga bilancet. Ulja e kredive me probleme është vërejtur në të gjitha kategoritë përbërëse, ku secila prej tyre ka shënuar rënie të vlerës. Në kreditë ekzistuese me probleme, cilësia më e dobët shfaqet në kredinë në valutë, kredinë për bizneset dhe kredinë me afat më të gjatë maturimi. Pakësimi i kredive me probleme është shoqëruar me përmirësimin e masës së mbulimit të tyre me fonde rezervë dhe me kapital, ndërkohë që niveli i kolateralizimit të kredisë është përmirësuar lehtë.

   Pakësimi i vlerës së kredive me probleme gjatë periudhës është një zhvillim i dukshëm pozitiv, i cili do të çlirojë burimet e bankave që angazhohen në administrimin e kredive me probleme, do të përmirësojë gradualisht perceptimin e sektorit bankar për rrezikun e veprimtarisë së kreditimit dhe do të sjellë nxitje më të fortë për rritjen e kreditimit në vazhdim. Në procesin e trajtimit të kredive me probleme, bankat po shfaqen më aktive në drejtim të ristrukturimit të tyre që në fazat më të hershme. Si rezultat, kjo do të ndikojë më mirë jo vetëm mbi uljen e stokut të kredive me probleme, por edhe mbi kontrollin e flukseve të reja të tyre. Gjithashtu, procesi do të jetë i dobishëm për të dalluar më shpejt projektet e vlefshme për t'u financuar, duke lejuar që bankat të veprojnë me shpejtësi më të madhe për të arkëtuar kredinë nga huamarrësit me performancë të ulët. Nga ana tjetër, procesi duhet të jetë i kujdesshëm dhe profesional, në mënyrë që ristrukturimet të jenë sa më efektive, shanset për përmirësim të aftësisë paguese të huamarrësve të jenë reale dhe elementet nxitëse për shlyerje të rregullt të kredisë nga ana e tyre të ruhen të forta. Megjithë përmirësimin e ndjeshëm, niveli i kredive me probleme në sektorin bankar vlerësohet ende i lartë. Kjo situatë kërkon që angazhimi i bankave në këtë proces të jetë i plotë dhe i vazhdueshëm.

b) *Rreziku i likuiditetit në veprimtarinë bankare vlerësohet i ulët.* Raportet e likuiditetit, në lekë dhe valutë, janë ndjeshëm mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator dhe burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Varësia nga linjat e huaja të financimit është mjaft e ulët.

Megjithatë, hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve sipas segmenteve të maturitetit të mbetur, në raport me totalin e aktiveve për afatin e shkurtër, konsiderohet në nivele të larta dhe në rritje kundrejt periudhave të kaluara. Në ruajtjen e këtij hendeku, kontribuon edhe ndryshimi i strukturës së detyrimeve, brenda të cilave pesha e depozitave me afat vijon të bjerë kundrejt burimeve të tjera pa afat. Kjo strukturë e burimeve i imponon sektorit bankar nevojën për të ruajtur nivele të larta të aktiveve likuide, si edhe për të kërkuar kthime më të larta nëpërmjet investimeve më afatgjata. Kjo veçori, lidhet me fazën aktuale të ciklit financiar dhe duhet të ndryshojë gradualisht në periudhën kur zhvillimet makroekonomike të kërkojnë rritje të normave të interesit, gjë që sjell rritje të kostos oportune të publikut për mbajtjen e kursimeve në forma shumë likuide.

c) *Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut mbetet i rëndësishëm.* Pozicioni i hapur neto valutor i sektorit bankar në raport me kapitalin rregullator është luhatur brenda niveleve afatgjata, duke dëshmuar për një ekspozim të kufizuar dhe në rënie të sektorit bankar ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilanc nga luhatjet në kursin e këmbimit. Gjatë periudhës është vërejtur që kredia në valutë për rastet kur huamarrësit i kanë të ardhurat në monedhë tjetër, ka mbetur e qëndrueshme si në raport me kredinë totale, ashtu edhe ndaj kredisë në valutë. Në të njëjtën kohë, cilësia e saj është përmirësuar. Përgjithësisht, këto zhvillime tregojnë që gjatë periudhës sektori bankar ka kontrolluar ecurinë e ekspozimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit, por ky ekspozim vlerësohet ende i lartë dhe është e nevojshme të veprohet në mënyrë më aktive për uljen e mëtejshme të tij. Banka e Shqipërisë beson se masat e propozuara në kuadër të strategjisë për uljen e masës së përdorimit të valutave në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare, do të kontribuojnë drejt këtij objektivi. Këto masa janë diskutuar me industrinë bankare dhe aktualisht ka nisur puna për përgatitjen e akteve të nevojshme rregullative.

Në lidhje me ndikimin e lëvizjeve në normën e interesit, sektori bankar mbetet i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit në kushtet kur diferenca midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit, sipas periudhave të riçmimit, është në vlera relativisht të larta. Mjedisi aktual me norma interesi relativisht të ulëta sugjeron nevojën që sektori bankar dhe institucionet e tjera financiare jobankare, si shoqëritë e sigurimit të jetës apo fondet private suplementare të pensionit dhe fondet e investimit, të vlerësojnë rregullisht ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, që do të jepnin lëvizjet e pafavorshme në normën e interesit mbi veprimtaritë e tyre.

d) *Disa nga grupet bankare evropiane që veprojnë në vendin tonë janë ende në procesin e ristrukturimit për përmirësimin e gjendjes financiare.* Në këtë proces përfshihen veprime të tilla si ristrukturimi i rrjetit,

ndryshimi i aksionerëve apo bashkimi me institucione të tjera. Zhvillimet në legjislacionin evropian në fushën e rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave, i kanë bërë këto procese më efektive dhe më të pandjeshme për klientët e bankave. Në të njëjtën kohë, këto përcaktime ligjore dhe veprimet operacionale evidentojnë rëndësinë e koordinimit të veprimeve midis autoriteteve përgjegjëse në vendet ku e shtrin veprimtarinë grupi bankar që ristrukturohet. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të monitorojë zhvillimet dhe të koordinojë veprimet potencialisht të nevojshme, me autoritetet përkatëse vendase dhe të huaja, në mënyrë që të përmbushet objektivi final i ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.

Rreziqet për stabilitetin financiar

Për vlerësimin e rreziqeve sistemike është analizuar ecuria e treguesve që lidhen me materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik, me nivelin e stresit në sistemin financiar dhe me perceptimin e industrisë bankare mbi ekspozimin e veprimtarisë bankare ndaj rrezikut sistemik. Gjithashtu, harta e stabilitetit financiar ofron një qasje të konsoliduar të vlerësimit për rreziqet ndaj stabilitetit financiar.

Indekset për materializimin dhe akumulimin e rreziqeve sistemike, tregojnë një ulje të rreziqeve për stabilitetin financiar gjatë periudhës. Në kuadrin makroekonomik, në këtë ecuri kanë ndikuar pozitivisht përmirësimi i rritjes ekonomike, zhvillimet pozitive në tregun e punës, ulja e deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, vijimi i konsolidimit fiskal dhe ulja e niveleve të borxhit për bizneset; në sektorin bankar, ndikim pozitiv kanë dhënë rënia e kredive me probleme, përmirësimi i performancës financiare, si edhe nivelet e mira të kapitalizimit dhe të likuiditetit të veprimtarisë. Vrojtimet tregojnë gjithashtu që perceptimi i rreziqeve sistemike nga ana e industrisë bankare është në nivele më të ulëta, ndikuar kryesisht nga përshpejtimi i rritjes ekonomike dhe përmirësimi i cilësisë së kredisë. Megjithatë, ndjeshmëria e bankave mbetet e konsiderueshme për pasiguritë që ende shoqërojnë procesin e ekzekutimit të kolateraleve.

Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet

Aftësia e sektorit bankar për të përballuar rreziqet, vlerësohet duke analizuar gjendjen e tij të kapitalizimit dhe të përfitueshmërisë, si edhe duke provuar përshtatshmërinë e këtyre treguesve në skenarë stresi nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës.

Në fund të periudhës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shënoi nivelin 16.3%, duke qenë 0.3 pikë përqindje më i lartë se niveli i fundit të vitit 2016, dhe dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar për këtë tregues

prej 12%. Rezultati financiar i sektorit u përmirësua gjatë periudhës. Treguesit e rentabilitetit të sektorit, kthimi mbi aktivet (RoA) dhe kthimi mbi kapitalin (RoE) rezultuan përkatësisht 1.6% dhe 16.7%, duke qenë respektivisht 0.9 pikë përqindje dhe 8.7 pikë përqindje më të larta sesa në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Megjithatë, në performancën financiare të sektorit evidentohet që ndikimin pozitiv e ka dhënë rënia e shpenzimeve për provigjione lidhur me rrezikun e kreditit, duke ritheksuar ndjeshmërinë e sektorit bankar ndaj vijueshmërisë së këtij procesi. Ndërkohë, rezultati financiar nga veprimtaria kryesore e ndërmjetësimit financiar, i pasqyruar në të ardhurat neto nga interesat, ka vijuar të bjerë. Rënia e të ardhurave neto nga interesat ka ardhur si pasojë e rënies së normave të kthimit nga investimet me ritme më të shpejta se rënia e shpenzimeve përkatëse, në kushtet e operimit për një kohë relativisht të gjatë në një mjedis me norma të ulëta interesi. Nga ana tjetër, përmirësimi në treguesin e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit reflekton tkurrjen e aktiveve të peshuara me rrezik, si rezultat i dobësisë së kreditimit dhe ndryshimeve rregullative për investimet në institucionet financiare jorezidente. Në këto kushte, nivelet mjaft të mira të treguesve të mësipërm mund të shfaqin një luhatshmëri më të lartë në të ardhmen dhe qëndrueshmëria e tyre në kohë duhet vlerësuar me kujdes.

Përshtatshmëria e niveleve të treguesve të mësipërm, është verifikuar gjatë ushtrimit të provës së rezistencës, me skenarë që supozojnë ndryshime të pafavorshme në treguesit makroekonomikë dhe financiarë për periudhën 2017-2018. Si edhe më parë, midis supozimeve ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, në skenarin e rënduar janë përfshirë tkurrja e ekonomisë, tkurrja e kredisë, rritja e shpejtë e normave mesatare të interesit dhe nënçmimi i fortë i kursit të këmbimit. Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës tregojnë që në skenarin bazë dhe në atë të moderuar sektori bankar mbetet i kapitalizuar, por do të kishte nevojë të rriste kapitalin në skenarin e rënduar.

Mbështetur në këtë analizë, Banka e Shqipërisë vlerëson se gjendja e kapitalizimit dhe e përfitueshmërisë së bankave paraqitet aktualisht e përshtatshme për të përballuar rreziqet e veprimtarisë. Por ecuria e tyre është e nevojshme të monitorohet në vazhdimësi nga bankat dhe të veprohet për të siguruar qëndrueshmërinë e treguesve në nivele sa më të përshtatshme për mbështetjen e veprimtarisë.

Në vijim, do të gjeni më të detajuar përmbajtjen e raportit të stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017.

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

Harta e stabilitetit financiar tregon shpërndarjen e rrezikut tek faktorët që përcaktojnë stabilitetin e sistemit financiar. Këta faktorë përfshijnë mjedisin ekonomik rrethues, të brendshëm e të jashtëm, sektorin bankar si dhe agjentët e ekonomisë reale: qeveria, bizneset dhe individët.

(1) Në krahasim me një vit më parë, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 (më tej, 'periudha'), **harta e stabilitetit financiar tregon përgjithësisht një ulje të rreziqeve në mjedisin ekonomik të jashtëm dhe të brendshëm, dhe evidenton zhvillime të ndryshme në rreziqet që lidhen me sektorin bankar dhe agjentët e ekonomisë reale.** Zbutja e rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm ekonomik reflekton kryesisht normat më të larta të rritjes ekonomike dhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik. Ekspozimi i ndryshëm ndaj rreziqeve tek faktorët e tjerë, reflekton veçoritë e tyre në drejtim të performancës financiare, strukturës së financimit, ecurisë dhe nivelit të borxhit.

(2) Më konkretisht,

- o në mjedisin e përgjithshëm ekonomik vërehet që:
  - rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "i ulët", në vijim të përmirësimit të ngushtimit të hendekut të prodhimit; rënies së madhësisë së borxhit të jashtëm; dhe nivelit të nevojave për financim nga burime të jashtme,
  - rreziku që vjen nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie gjatë periudhës, kryesisht për shkak të ecurisë pozitive ekonomike të partnerëve tanë tregtarë dhe mjedisit me norma të ulëta financimi;

- o tek agjentët e ekonomisë reale, vërehet që:
  - rreziku nga "individët", vlerësohet "i moderuar" dhe në rritje, për shkak të zhvillimeve në tregun e banesave dhe pritshmërive më të ulëta të individëve,
  - rreziku nga "bizneset", vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, në kushtet e përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë për këtë kategori, zhvillimeve në indeksin e vëllimit të prodhimit dhe pritshmërisë në rritje të vet sektorit privat,
  - për "qeverinë", niveli i rrezikut vijon të vlerësohet "i ulët" dhe i pandryshuar gjatë periudhës së analizuar, mbështetur në qëndrueshmërinë e primit të rrezikut sovran, nivelin e ulët të kostos së borxhit dhe ecurinë e mirë të të ardhurave tatimore;

- ndërsa, në veprimtarinë e sektorit bankar vërehet që:
  - niveli i rrezikut nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria", vlerësohet "mesatar" dhe i pandryshuar gjatë periudhës. Niveli i kapitalizimit dhe cilësia e kredive janë përmirësuar duke kontribuar në uljen e rrezikut nga kjo kategori, ndërkohë që kontributi i të ardhurave nga interesat në nivelin e përgjithshëm të përfitueshmërisë ka ardhur në rënie,
  - rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" vlerësohet "i moderuar" dhe sërish në rritje. Ky zhvillim reflekton thellimin e hendekut midis aktiveve dhe pasiveve të bankave me afat deri në 3 muaj[3], si dhe një rritje më të ulët të depozitave të individëve. Vijimi i rënies së vlerave të treguesve të likuiditetit, krahasuar me nivelet e larta të së kaluarës, sinjalizon një përmirësim të ndërmjetësimit nga ana e sektorit bankar dhe angazhim më të madh në orientimin e burimeve financiare drejt kreditimit të ekonomisë. Në afatin e gjatë, shpërndarja më efektive e burimeve financiare të sektorit bankar pritet të mbështesë më tej aktivitetin ekonomik në vend, si dhe të ndikojë pozitivisht mbi kapitalizimin dhe performancën financiare të sektorit,
  - së fundi, vlerësimi i rrezikut që lidhet me "strukturën e sektorit bankar", vijon të mbetet i pandryshuar në nivelin "i ulët", mbështetur nga një diversifikim i mirë i fondeve të financimit dhe përmirësimi i shpërndarjes së kreditimit në sektorin bankar, duke balancuar disi rrezikun nga përqendrimi ende i lartë i kredisë brenda segmentit "biznese".

Grafik 1.1 Harta e stabilitetit financiar



*Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Hapësira informuese 1.1 paraqet të gjithë përbërësit e kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, vlerësimet me "notë" për nivelin e rrezikut për secilin përbërës dhe krahasimin me vlerësimin e një viti më parë.

[3] *Brenda kësaj kategorie, e cila përgjithësisht është vlerësuar me rrezik të ulët, ky kapërcim është rrjedhojë e ndryshimit të përkufizimit të vetë termit për qëllime të analizave më të hollësishme nga autoriteti mbikëqyrës.*

HAPËSIRË INFORMUESE 1.1. PËRBËRËSIT E HARTËS SË STABILITETIT FINANCIAR

Rreziku nga "ekonomia e brendshme" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie, në vijim të përmirësimit të hendekut të prodhimit, madhësisë së borxhit të jashtëm dhe nevojave për financim të jashtëm.

EKONOMIA E BRENDSHME, Qershor 2017



Rreziku për "individët" vlerësohet i "moderuar" dhe në rritje, për shkak të rënies së pritshmërisë së individëve dhe zhvillimeve në tregun e banesave.

INDIVIDËT, Qershor 2017



Rreziku për "bizneset" vlerësohet "mesatar" dhe në rënie, në reflektim të përmirësimit të cilësisë së kredisë, pritshmërive të bizneseve dhe indeksit të vëllimit të prodhimit.

BIZNESET, Qershor 2017



Rreziku që vjen nga "qeveria" vlerësohet i "ulët" dhe i pandryshuar, mbështetur në primin e rrezikut sovran, koston e borxhit dhe ecurinë e të ardhurave tatimore.

QEVERIA, Qershor 2017



Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" vlerësohet "i ulët" dhe në rënie ndaj qershorit 2016, ndikuar nga përmirësimi i rritjes ekonomike të partnerëve tregtarë dhe ecuria e indeksit CLI total. Rritja e çmimeve të naftës dhe ecuria e normave afatshkurtra ndërkombëtare kontribuan në rritjen e këtij rreziku.

MJEDISI I JASHTËM, Qershor 2017



Niveli i rrezikut nga "kapitali dhe përfitueshmëria" vlerësohet "i ulët" dhe i pandryshuar gjatë periudhës. Rritja e rrezikut nga rënia e të ardhurave nga interesi është balancuar nga përmirësimi i treguesve të tjerë, si rënia e kredive me probleme dhe përmirësimi i nivelit të kapitalit.

KAPITALI DHE PËRFITUESHMËRIA, Qershor 2017



Rreziku që vjen nga "financimi dhe likuiditeti" ka rezultuar në nivelin "i moderuar" dhe në rritje gjatë periudhës, për shkak të thellimit të hendekut midis aktiveve dhe pasiveve afatshkurta deri në 3 muaj.

FINANCIMI DHE LIKUIDITETI, Qershor 2017



Rreziku që lidhet me "strukturën e sektorit bankar" ka vijuar të jetë i ulët dhe i pandryshuar, në kushtet e rritjes së diversifikimit të fondeve të financimit të tij dhe të nivelit të RMK-së ndaj minimumit rregullator.

STRUKTURA E SEKTORIT BANKAR, Qershor 2017



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë.

1.1 RREZIKU SISTEMIK[4]

Vlerësimi i ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik kryhet duke analizuar ecurinë e treguesve që lidhen me: a) materializimin dhe me akumulimin e rrezikut sistemik; b) nivelin e stresit në sistemin financiar; c) perceptimin e industrisë bankare mbi ekspozimin e veprimtarisë së saj ndaj rreziqeve sistemike. Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik ofron një vlerësim lidhur me nivelin aktual të rrezikut, ndërsa indekset e akumulimit të rrezikut, të stresit financiar dhe të perceptimit të industrisë bankare rreth tij, fokusohen kryesisht drejt së ardhmes.

(3) Materializimi i rrezikut sistemik ka shfaqur rënie gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë. Në këtë ecuri të indeksit, kanë ndikuar përmirësimi i cilësisë së kredisë për individët dhe bizneset, rënia e nivelit të papunësisë në vend, si dhe rënia e luhatshmërisë në ecurinë e kursit të këmbimit (Grafik 1.2).

(4) Akumulimi i rrezikut sistemik dhe indeksi i stresit financiar kanë rezultuar gjithashtu në rënie. Në ecurinë e indeksit të akumulimit të rrezikut sistemik, ulja e nivelit të borxhit të bizneseve, rënia e borxhit publik dhe ngushtimi i deficitit të llogarisë korrente kanë dhënë kontributin kryesor në uljen e akumulimit të rrezikut. Në vijim, edhe ecuria e indeksit të stresit financiar ka qenë në rënie. Në rënie kontribuan zbutja e mëtejshme e presioneve nënçmuese të monedhës vendase dhe zhvillimet në tregun ndërbankar (Grafik 1.3).

(5) Perceptimi i industrisë bankare paraqet një vlerësim më pozitiv për ecurinë e rreziqeve sistemike gjatë periudhës. Kështu, rreziku potencial nga "përkeqësimi i ekonomisë së brendshme", ndonëse vijon të konsiderohet si rreziku kryesor sistemik në vend, perceptohet ndjeshëm më i zbutur nën ndikimin e rritjes më të lartë ekonomike në vend. Perceptimi mbi rrezikun që buron nga procesi i "ekzekutimit të kolateraleve" mbetet relativisht i lartë dhe ka qenë i pandryshuar gjatë periudhës. Në dallim nga periudhat e kaluara, në gjysmën e parë të vitit 2017 është rritur ndjeshmëria e sektorit

Grafik 1.2 Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 1.3 Indeksi i Stresit Financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[4] *Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".*

bankar ndaj "rrezikut politik në vend", ndikuar kryesisht nga rritja e përkohshme e pasigurisë në prag të zgjedhjeve të përgjithshme politike të qershorit 2017. Rreziqet e lidhura me procesin e kredisë vijojnë të klasifikohen ndër rreziqet më të rëndësishme sistemike, duke qenë se portofoli i kredive me probleme, pavarësisht përmirësimit të ndjeshëm, mbetet ende në nivele të larta. Së fundi, vlerësimi i bankave lidhur me 'rrezikun e goditjeve nga jashtë' ka vijuar prirjen rënëse të konstatuar që një vit më parë (Grafik 1.4).

Grafik 1.4 Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike



Niveli i rrezikut:				
Shumë i lartë	I lartë	Mesatar	I ulët	Shumë i ulët
(80-65)	(64-49)	(48-33)	(32-17)	(16-0)

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

(6) Gjatë periudhës, zhvillimet në ekonominë botërore kanë qenë përgjithësisht pozitive. Rritja ekonomike ka qenë më e shpejtë në tremujorin e dytë, mbështetur kryesisht nga kushtet e favorshme të financimit dhe vijimi i politikave stimuluese në vendet e zhvilluara dhe një pjesë e vendeve në zhvillim. Rikuperimi i pjesshëm i çmimit të naftës në fund të vitit të kaluar, ndihmoi disi ekonomitë e vendeve eksportuese. Kjo ecuri rezultoi jetëshkurtër dhe çmimet u rikthyen në nivelet e mëparshme. Kushtet në tregjet financiare kanë qenë përgjithësisht të favorshme, pavarësisht thellimit të divergjencave ndërmjet politikave monetare të vendeve të zhvilluara. Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe bankat e tjera të mëdha kanë vijuar të ndjekin politika monetare lehtësuese, ndërsa Rezerva Federale ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm drejt shtrëngimit të politikës së saj monetare. Presionet inflacioniste në nivel global kanë mbetur të ndrydhura, ndikuar nga ecuria e çmimeve të naftës dhe lëndëve të para. Normat e inflacionit në vendet e zhvilluara janë rikthyer në nivele poshtë vlerave të synuara nga bankat qendrore, ndërsa në vendet në zhvillim kanë qenë të stabilizuara ose në rënie. Këto zhvillime kanë bërë që FMN-ja të vlerësojë një rritje globale prej 3.5% për vitin 2017 dhe 3.6% në vitin 2018[5], mbështetur pozitivisht si nga ecuria ekonomike e vendeve të zhvilluara, ashtu edhe e atyre në zhvillim.

(7) Rritja ekonomike është përshpejtuar në vendet e zhvilluara dhe ka ruajtur prirjen pozitive në vendet në zhvillim. Mes *rajoneve të zhvilluara*, ecuria ekonomike e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) është përmirësuar gjatë tremujorit të dytë të vitit, pas një nisjeje më të dobët në fillim të tij. Rritja është mbështetur kryesisht nga kontributi pozitiv i shpenzimeve konsumatore dhe inventarëve. Kushtet në tregun e punës kanë vijuar të përmirësohen dhe norma e papunësisë ka rënë në 4.4%. Në Mbretërinë e Bashkuar, aktiviteti ekonomik është ngadalësuar gjatë këtij viti si rezultat i rënies së konsumit privat, ndikuar nga zhvlerësimi i paundit dhe rritja e normës së inflacionit. Në *rajonet në zhvillim*, ecuria ekonomike ka qenë përgjithësisht pozitive. Gjithsesi, diferencat midis vendeve kanë mbetur të theksuara, diktuar nga një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm. Kështu, politikat fiskale stimuluese kanë vijuar të mbështesin ecurinë e qëndrueshme ekonomike në Kinës, ndërkohë që rikuperimi i çmimit të naftës në fund të vitit të kaluar dhe pritjet pozitive mbi tregtinë globale, kanë ofruar mbështetje për ekonomitë eksportuese.

(8) Rritja ekonomike e Eurozonës ka qenë më e balancuar. Shumica e vendeve të këtij rajoni kanë regjistruar rritje ekonomike pozitive, mbështetur kryesisht nga kërkesa e brendshme dhe pjesërisht nga kontributi pozitiv

[5] *Parashikim i muajit korrik 2017.*

i inventarëve. Kushtet në tregun e punës kanë vijuar të përmirësohen duke mbështetur rritjen e të ardhurave dhe konsumin e familjeve. Punësimi është rritur duke iu afruar niveleve të parakrizës, ndërkohë që norma e papunësisë në fund të gjashtëmujorit ka rënë në nivelin 9.1%.

(9) Në sektorin bankar në Eurozonë, kreditimi në tërësi është rritur dhe kontributin kryesor e ka dhënë kredimarrja nga familjet. Lehtësimi i vazhdueshme i standardeve të kreditimit dhe kostot e ulëta të financimit, kanë nxitur kërkesën dhe ofertën për kredi në shumicën e vendeve të Eurozonës. Nga ana tjetër, pavarësisht progresit të dukshëm të një pjese të bankave evropiane në pastrimin dhe konsolidimin e bilanceve të tyre, niveli ende i lartë i kredive me probleme vazhdon të frenojë rigjallërimin e kreditimit.

(10) Rritja ekonomike botërore pritet të vazhdojë edhe për periudhën 2017-2018. Peshën kryesore do ta kenë rajonet në zhvillim, ekonomia e të cilave pritet të përmirësohet më tej gjatë dy viteve të ardhshme. Vendet e zhvilluara gjithashtu do të vazhdojnë të rikuperohen, por ritmi i tyre pritet të zbutet gjatë vitit të ardhshëm. Normalizimi i politikës monetare në vendet e zhvilluara dhe reagimi i tregjeve lidhur me to, përbën aktualisht rrezikun kryesor mbi perspektivën e ekonomisë globale. Nga ana tjetër, rreziqet e lidhura me presionet e ulëta inflacioniste, ecurinë e çmimit të naftës, dobësitë strukturore makroekonomike në vendet në zhvillim apo procesi i papërfunduar i konsolidimit të bilanceve të institucioneve financiare në vendet e zhvilluara, vijojnë të mbeten të pranishme në mjedisin makroekonomik global.

(11) Në Eurozonë, transmetimi i politikës monetare në ekonominë reale do të vazhdojë të mbështesë rritjen e kërkesës së brendshme dhe të lehtësojë procesin e konsolidimit të bilanceve të sektorit privat e shtetëror. Kushtet e favorshme të financimit dhe rritja e përfitueshmërisë së sektorit privat, do të stimulojë më tej rritjen e investimeve, ndërkohë që rikuperimi i ekonomisë globale pritet të favorizojë eksportet evropiane. Përmirësimi i kushteve në tregun e punës do të vazhdojë të kontribuojë pozitivisht në rritjen e konsumit privat përmes rritjes së të ardhurave të disponueshme të familjeve. Rreziqet kryesore ndaj pritjeve për ecurinë ekonomike të Eurozonës lidhen kryesisht me faktorë të jashtëm si politikat e administratës së SHBA-së dhe vendosja e marrëdhënieve të reja me Mbretërinë e Bashkuar pas "Brexit". Megjithatë, në disa prej vendeve të këtij rajoni vijojnë të mbeten të pranishme rreziqe të brendshme si tejzgjatja e reformave strukturore dhe ngadalësia në konsolidimin e bilanceve në sektorë të caktuar.

Tabela 2.1 Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi bruto i qeverisë (% PBB)	
	T1'17	T2'17	2017p	2018p	Mar'17	Qer'17	Mar'17	Qer'17	T4'16	T1'17
SHBA	1.2	2.6	2.1	2.1	2.4	1.6	4.5	4.4	105.7	104.1
Eurozonë	1.9	2.1	1.9	1.7	1.5	1.3	9.4	9.1	89.2	89.5
- Gjermani	1.7	:	1.8	1.6	1.5	1.5	3.9	3.8	68.3	66.9
- Francë	1.0	:	1.5	1.7	1.4	0.8	9.6	9.6	96.3	98.7
- Itali	1.2	:	1.3	1.0	1.4	1.2	11.5	11.1	132.6	134.7
- Greqi	0.4	:	:	:	1.7	0.9	22.0	:	179.0	176.2

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, BEA (Bureau of Economic Analysis), Bureau of Labour Statistics, FMN; p-parashikime të FMN-së, korrik 2017; nuk ka të dhëna të disponueshme.

(12) **Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, rritja ekonomike ishte e kënaqshme në mbyllje të vitit 2016, veçanërisht në Serbi dhe Shqipëri, por ritmi u moderua disi gjatë tremujorit të parë të vitit 2017**. Aktiviteti ekonomik i vendeve të rajonit dhe Turqisë u zgjerua me 2.8% (rritje vjetore) në tremujorin e fundit të vitit 2016, por u ngadalësua në 1.8% në tremujorin e parë të këtij viti. Me përjashtim të Maqedonisë, të gjitha vendet e rajonit kanë shënuar rritje pozitive gjatë tremujorit të parë të 2017-ës, mbështetur kryesisht nga konsumi privat dhe investimet. Gjithsesi, me përjashtim të Kosovës ku ritmi i rritjes ekonomike i ka tejkaluar pritjet, aktiviteti në vendet e tjera është ngadalësuar. Rritje të përshpejtuar ekonomike ka shënuar dhe Turqia, ku kontributin kryesor e ka pasur tregtia dhe rritja e shpenzimeve publike si rezultat i përpjekjeve të qeverisë për të mbështetur ekonominë e vendit. Pavarësisht problematikave specifike, kushtet në tregun e punës kanë vijuar të përmirësohen, gjë që është reflektuar dhe në rritjen e nivelit të punësimit dhe rënien e normës së papunësisë. Presionet e ulëta inflacioniste vazhdojnë të jenë karakteristikë e vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke reflektuar çmimet e ulëta të lëndëve të para dhe qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit të monedhave. Në sektorin bankar, kreditimi ka vijuar të mbështesë rritjen ekonomike në rajon. Në të gjitha vendet, rritja e kredisë për sektorin e familjeve ka tejkaluar atë të sektorit të bizneseve. Gjatë tremujorit të parë të vitit, shumica e vendeve të rajonit kanë reduktuar portofolin e kredive me probleme dhe kanë përmirësuar kuadrin e trajtimit të tyre. Gjithsesi, ky tregues mbetet ende në nivele të larta, duke frenuar rigjallërimin e kredidhënies në rajon.

Tabela 2.2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)			Papunësia (% vjetore)		Borxhi sovran (% e PBB-së)		Rritja e kredisë (% vjetore)		Raporti i kredive me probleme	
	T4'16	T1'17	2017p	T4'16	T1'17	T4'16	T1'17	T4'16	T1'17	T4'16	T1'17
B&H	2.6	:	:	25.4	:	41.4	:	1.8	3.0	11.8	11.5
Maqedoni	2.4	0.0	2.9	23.1	22.9	40.9	37.8	1.4	0.1	6.3	6.1
Mal i Zi	3.4	3.2	3.3	17.9	17.7	62.4	61.6	1.3	5.5	10.3	9.9
Kosovë	3.0	3.8	:	27.5	:	14.5	:	9.9	10.6	4.9	:
Serbi	2.5	1.2	3.2	13.0	14.6	72.8	71.5	9.0	7.6	17.0	16.8

Burimi: Komisioni Evropian, parashikimi i ECFIN-it, 2017.

2.1 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE TË LËNDËVE TË PARA

(13) Gjatë periudhës, zhvillimet në tregjet financiare globale kanë qenë përgjithësisht të favorshme dhe të qëndrueshme. Tronditjet e fundit të vitit të kaluar lidhur me zgjedhjet presidenciale në SHBA dhe Francë, dhe kthesa në politikën monetare të SHBA-së u asimiluan shpejt nga tregjet. Rritjet e normës bazë të interesit nga Rezerva Federale gjatë vitit 2017 shkaktuan luhatje minimale në tregje, ndikuar nga pritjet se shtrëngimi monetar do të realizohet në mënyrë graduale, ndërkohë që bankat e tjera kryesore qendrore (BQE, Banka e Anglisë dhe Banka e Japonisë) pritet të vijojnë politikat monetare akomoduese. Ecuria e vlerave dhe normave në tregjet e zhvilluara gjithashtu është ndikuar pozitivisht nga ecuria e mirë ekonomike e këtyre vendeve dhe pritjet optimiste për të ardhmen. Normat e kthimit në tregjet evropiane dhe amerikane të titujve të borxhit qeveritar kanë rënë dhe *spread*-et janë ngushtuar, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit, duke pasqyruar rënien e perceptimit të investitorëve mbi rrezikun. Kjo ecuri ka nxitur paralelisht rritjen e çmimeve në tregjet e aksioneve për sektorin financiar dhe atë jofinanciar. Tregjet e parasë kanë vijuar të karakterizohen nga norma negative dhe nivele të bollshme likuiditeti, duke reflektuar qëndrimin e politikave monetare në shumicën e vendeve të zhvilluara.

Grafik 2.1 Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 2.2 Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

(14) Pritjet për të ardhmen e politikave monetare dhe dallimet në fazat e ciklit ekonomik mes vendeve kanë diktuar lëvizjet e kursit të këmbimit. Kështu, gjatë tremujorit të dytë të vitit, euro përgjithësisht u mbiçmua kundrejt monedhave të vendeve të zhvilluara, si dollari amerikan dhe franga zvicerane, si dhe kundrejt monedhave të një pjese të mirë të rajoneve në zhvillim.

(15) Rikuperimi i çmimeve të naftës në fund të vitit të kaluar dhe në fillimin e vitit 2017, duket se është frenuar i diktuar kryesisht nga faktorë të lidhur me ofertën. Efektet e marrëveshjes mes prodhuesve kryesorë të naftës[6] për të ulur kuotat e prodhimit, duket se rezultuan të përkohshme, ndikuar dhe nga rritja e inventarëve të SHBA-së. Si rezultat, çmimet e naftës bruto në periudhën mars-qershor 2017 u luhatën në nivelet 46 deri 56 dollarë amerikanë për

[6] *Në qershor 2016 u lidh marrëveshja (ratifikuar më 30 nëntor 2016) mes vendeve OPEC dhe 11 vendeve joOPEC për reduktimin e kuotave të prodhimit të naftës respektivisht me 1.27 dhe 0.6 milion fuçi në ditë. Më 25 maj 2017, kjo marrëveshje u shty dhe për 9 muaj të tjerë.*

fuçi. Zgjatja e marrëveshjes për reduktimin e prodhimit edhe për 9 muaj të tjerë duket se ishte paraprirë nga tregjet, ndaj nuk dha efektin e dëshiruar në rritjen e çmimit të naftës. Çmimet e lëndëve të tjera të para, veçanërisht të metaleve, qenë gjithashtu në rënie që nga muaji mars 2017, ndikuar kryesisht nga rënia e kërkesës së Kinës.

HAPËSIRË INFORMUESE 2.1. ZHVILLIMET NË GRUPET BANKARE TË HUAJA QË OPEROJNË NË SHQIPËRI

Në fund të periudhës, grupet e huaja bankare që zhvillojnë aktivitetin në vendin tonë paraqesin nivele të qëndrueshme kapitalizimi, ndonëse rezultati financiar në disa prej tyre ka qenë negativ. Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa tregues kryesorë të pasqyrave financiare të grupeve bankare zotëruese që operojnë në Shqipëri, në terma relativë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për sa i takon ecurisë së peshës së filialeve shqiptare në aktivitetin e grupit bankar, lëvizjet gjatë periudhës kanë reflektuar specifikën e veprimtarisë së secilës palë.

Tabelë 2.3. Zhvillimet në grupet e huaja bankare që operojnë në Shqipëri

Ndryshim (%)	Raiffesen Bank International[1]	Intesa San Paolo[2]	Alpha Bank[3]	Piraeus Bank[4]	National Bank of Greece[5]	Societe Generale[6]
Aktivet	2.8%	2.3%	-6.0%	-11.0%	-10.5%	-2.3%
Kredi	1.7%	1.2%	-3.6%	-3.0%	-3.5%	-1.9%
Depozita	1.6%	-2.7%	6.9%	7.0%	0.8%	-3.5%
Provigjione	-81.1%	-75.0%	-3.6%	-6.0%	-67.9%	-6.7%
Fitimi neto	...	...	...	(...)	-59.4%	-24.3%
Të ardhura operative	5.0%	-1.0%	0.6%	3.0%	7.6%	-26.1%
Të ardhura neto nga interesi	1.3%	-1.8%	1.4%	-2.0%	0.3%	-12.1%
Të ardhura neto nga komisionet	8.9%	5.8%	-1.8%	10.0%	...	-
Shpenzime operative	2.0%	0%	-7.2%	-4.0%	5.9%	4.4%
Rezultati neto operativ	9.4%	-1.9%	-	4.0%	-53.0%	19.9%
Raporte						
Kredi me probleme	7.3%	3.8%	38.1%	37.8%	-	4.6%
Marzhi neto nga interesat	2.46%	-	3.0%	2.7%	3.04%	-
Mjaftueshmëria e kapitalit	12.9%	13.0%	17.2%	16.3%	16.0%	14.4%
Aktivet e bankës në Shqipëri ndaj totalit të grupit	1.38%	0.15%	0.81%	0.72%	0.38%	0.05%

Shënim: Shenja (...) tregon ndryshim të theksuar të këtij treguesi (mbi 100%), qoftë në terma pozitivë apo negativë.
Ndërsa shenja (-) tregon të dhëna të padisponueshme për këtë tregues në publikimet e bankës përkatëse.
Burimi: Faqet zyrtare të grupeve bankare.

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2017, u krye një ristrukturim i plotë i veprimtarisë së grupit bankar "Veneto Banca", pas vendimit të Bankës së Italisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë. Pjesa më e mirë e veprimtarisë së këtij grupi, ku përfshihen edhe filialet e tij në Shqipëri dhe në disa vende të tjera, i kanë kaluar Bankës Intesa Sanpaolo, grupi më i madh bankar në Itali. Ky ndryshim është konfirmuar edhe në njoftimin për shtyp të grupit bankar Intesa Sanpaolo të datës 26 qershor 2017. Për sektorin bankar shqiptar, kjo do të thotë që "Banka Veneto" sh.a, deri më parë e zotëruar plotësisht nga grupi bankar "Veneto Banca", tani do të zotërohet nga grupi bankar "Intesa Sanpaolo" dhe aktiviteti i saj do të bëhet pjesë e këtij grupi bankar.

Disa nga grupet bankare evropiane që veprojnë në vendin tonë, gjenden ende në procesin e ristrukturimit për përmirësimin e gjendjes financiare. Si pjesë e këtij procesi, përfshihen veprime të tilla si: ristrukturimi i rrjetit, ndryshimi i aksionerëve apo bashkimi me institucione të tjera. Zhvillimet në legjislacionin evropian në fushën e rikuperimit dhe zgjidhjes së bankave, i kanë bërë këto procese më efektive dhe më të pandjeshme për klientët e bankave. Në të njëjtën kohë, këto përcaktime ligjore dhe veprimet operacionale evidentojnë rëndësinë e koordinimit të veprimeve mes autoriteteve përgjegjëse në vendet ku e shtrin veprimtarinë grupi bankar që ristrukturohet. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të monitorojë zhvillimet dhe të koordinojë veprimet potencialisht të nevojshme, me autoritetet përkatëse vendase dhe të huaja, në mënyrë që të përmbushet objektivi final i ruajtjes së stabilitetit të sistemit financiar.

3 ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË VEND

(16) Ekonomia shqiptare përshpejtoi ritmin vjetor të rritjes së saj, në 3.94%, në tremujorin e parë të vitit. Në rritjen ekonomike kontribuan sektorët e shërbimeve, të prodhimit dhe të bujqësisë, dhe spikatën degët e tregtisë, ndërtimit, transportit dhe industrisë. Rritja e kërkesës agregate u mbështet nga zgjerimi i konsumit final të popullatës (me peshën kryesore), rritja e konsumit të qeverisë dhe formimi i kapitalit fiks. Gjithashtu, në zgjerimin e kërkesës ka kontribuar pozitivisht edhe ngushtimi i deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve. Zhvillime pozitive regjistron edhe tregu i punës, ku norma e papunësisë shënoi nivelin 14.2%[7]. Për pjesën e mbetur të vitit, pritshmëritë mbi nivelet e punësimit mbeten pozitive për të gjithë sektorët e ekonomisë.

(17) Në vijim të presioneve të përmbajtura të inflacionit, politika monetare ka mbetur lehtësuese për të nxitur zgjerimin e aktivitetit ekonomik, gjatë periudhës. Kushtet monetare stimuluese kanë mbështetur ecurinë e kreditimit, duke ndikuar në gjallërimin e konsumit dhe të investimeve private. Në këtë mënyrë është synuar të ndikohet kthimi gradual i normës së inflacionit pranë nivelit të objektivit. Në qershor 2017, inflacioni vjetor arriti në nivelin 2.2%, me rritje ndaj të njëjtës periudhë të vitit të kaluar[8]. Qëndrueshmëria e inflacionit u ndikua kryesisht nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik dhe prirja rritëse e çmimeve në tregjet botërore. Banka e Shqipërisë pret që efekti i këtyre faktorëve të shtrihet edhe në periudhat në vijim, duke bërë që vlerat e inflacionit të lëvizin drejt nivelit objektiv prej 3% në afatin e mesëm.

(18) Procesi i konsolidimit fiskal shfaqi një ritëm më të ulët gjatë periudhës. Në fund të periudhës, teprica buxhetore ishte pozitive për rreth 3.1 miliardë lekë, kundrejt vlerës prej 17.2 miliardë lekësh një vit më parë. Në tkurrjen e suficitit buxhetor ndikoi rritja e shpenzimeve buxhetore me ritëm më të lartë se rritja e të ardhurave[9]. Me gjithë impulsin pozitiv që ka dhënë tkurrja e suficitit buxhetor në afat të shkurtër në rritjen ekonomike, procesi i konsolidimit fiskal është i nevojshëm të vijojë për të siguruar qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike në afat më të gjatë. Me rëndësi në këtë proces është planifikimi sa më i mirë i zërave kryesorë të buxhetit dhe përmirësimi i shkallës së realizimit të shpenzimeve kapitale.

---

[7] *Norma e papunësisë shënonte nivelin prej 16.6% në T1 2016, ndërsa mbetet thuajse në të njëjtin nivel më dhjetor 2016: 14.17%.*

[8] *Më konkretisht, në dhjetor 2016, kjo normë shënoi vlerën 2.2% përkundër vlerës 1.2% në qershor të 2016-ës*

[9] *Të ardhurat vjetore shënuan një vlerë kumulative prej 212.2 miliardë lekësh (7.0% rritje vjetore), ndërsa shpenzimet e përgjithshme shënuan vlerën 209.2 miliardë lekë (15.5% rritje vjetore).*

(19) Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv, me zgjerim të mjeteve valutore (rezervës) gjatë tremujorit të parë të vitit 2017. Në fund të këtij tremujori, deficiti i llogarisë korrente në bilancin e pagesave u ul ndjeshëm, duke u tkurrur me 20% në terma vjetorë, në vlerën 179 milionë euro. Në këtë ecuri, ndikuan përmirësimi i tepricës pozitive në llogarinë e shërbimeve[10] dhe zgjerimi më i ngadaltë i deficitit tregtar në mallra për shkak të rritjes më të shpejtë të eksporteve[11]. Flukset hyrëse në llogarinë e të ardhurave dytësore nuk kishin ndryshime thelbësore kundrejt një viti më parë[12]. Brenda kësaj kategorie, dërgesat e emigrantëve zënë rreth 80% të totalit dhe vlerësohet të kenë sjellë prurje valutore në nivelin prej rreth 137 milionë eurosh. Ngushtimi i deficitit tregtar në mallrave i dedikohet: (i) rritjes së eksportit të produkteve minerale në zërin "Xeherorët, zgjyrat dhe hiri" dhe (ii) rritjes së eksporteve në zërin "Metale bazë dhe artikujt prej tyre (giza dhe çeliku)". Fluksi i detyrimeve financiare të Shqipërisë me botën vlerësohet 272 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej rreth 2%. Detyrimet financiare u krijuan në masën më të madhe nga investimet e huaja direkte hyrëse, të cilat rezultuan 168 milionë euro, duke qenë rreth 8% më të larta se një vit më parë. Kontributin kryesor në rritjen e investimeve të huaja direkte hyrëse vijon ta japë sektori i energjetikës dhe ai i hidrokarbureve. Detyrimet në formën e investimeve të tjera shënuan rritje prej rreth 4% në terma vjetorë ose një zgjerim prej 128 milionë eurosh.

---

[10] *Zgjerimi i suficitit të kësaj llogarie i detyrohet kryesisht rritjes së të ardhurave nga shërbimet e biznesit, të transportit dhe të udhëtimit (bilanci për këtë të fundit, rezultoi 76 milionë euro, 12% më i lartë kundrejt një viti më parë). Teprica pozitive për llogarinë e shërbimeve, rezultoi 274 milionë euro, duke qenë 98 milionë euro më e lartë se e njëjta periudhë një vit më parë.*

[11] *Kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë, eksportet u rritën me 45%, ndërsa importet u rritën vetëm me 9%, duke shënuar vlerat prej respektivisht 182 dhe 769 milionë euro.*

[12] *Flukset dytësore arritën në nivelin prej 170 milionë eurosh.*

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(20) Individët mbetën të orientuar drejt kursimit, por me prirje rënëse, ndërsa bizneset ngushtuan pozicionin e tyre neto debitor, gjatë periudhës. Rritja e kredisë në lekë për individët dhe rënia e depozitave të tyre, ka ndikuar në ngushtimin e pozicionit të tyre kreditor[13]. Për të njëjtën periudhë, kredia për bizneset ka regjistruar rënie me një ritëm më të lartë se rënia e depozitave, duke ngushtuar pozicionin e tyre debitor[14]. Në terma vjetorë, ndryshe nga prirja gjashtëmujore, individët shfaqin një zgjerim të lehtë të pozicionit kreditor me kontribut nga pozicioni kreditor në valutë[15]. Ndërsa bizneset shfaqin një tkurrje më të ndjeshme të pozicionit neto debitor në sajë të rënies së ndjeshme të kredisë dhe zgjerimit të depozitave, kryesisht në valutë[16]. Procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave është shoqëruar me përmirësim të ndjeshëm vjetor të cilësisë së kredisë në tërësi dhe veçanërisht për kredinë e pambrojtur në valutë.

4.1 POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(21) Pozicioni kreditor i individëve ra në nivelin 765.4 miliardë lekë, ndikuar nga rënia e depozitave kryesisht në valutë dhe rritja e kredisë, gjatë periudhës. Orientimi i kredisë së individëve në monedhën vendase ka kontribuar në ngushtimin e pozicionit kreditor në lekë me ritëm më të lartë se ai në valutë[17]. Edhe bizneset kanë ngushtuar pozicionin e tyre debitor ndaj sektorit bankar duke arritur në nivelin 158.2 miliardë lekë. Ngushtimi i pozicionit debitor të bizneseve është ndikuar nga ngushtimi i pozicionit në monedhën e huaj, për shkak të tkurrjes më të shpejtë të kreditimit në krahasim me rënien e depozitave.

---

[13] *Pozicioni kreditor shënon një ngushtim me rreth 2.3% gjatë periudhës, ndikuar njëkohësisht nga rënia e nivelit të depozitave me 1.4% krahas rritjes së kredisë me 2.9%. Brenda kësaj të fundit, kredia në lekë u rrit me 4.9% përkundër rritjes me vetëm 0.5% të asaj në monedhë të huaj; ndërsa depozitat në monedhë të huaj dhe lekë ranë me përkatësisht 1.8% dhe 1.0%.*

[14] *Pozicioni debitor gjatë periudhës u ngushtua me 5.1%, rrjedhojë e ngushtimit të pozicionit në valutë (12.2%), kryesisht falë rënies së kredisë në këtë monedhë (6.6%). Ndërkaq, depozitat ranë me 1.4%, ndikuar kryesisht nga rënia e depozitave në lekë me 2.4% përkundër rënies me 0.8% të atyre në monedhë të huaj.*

[15] *Në terma vjetorë, regjistrohet një zgjerim prej rreth 1.2% i pozicionit kreditor të individëve falë zgjerimit të atij në monedhë të huaj me 2.9%.*

[16] *Ngushtimi i pozicionit debitor në terma vjetorë ishte rreth 39% dhe u ndikua si nga ngushtimi i pozicionit në lekë, ashtu edhe i atij në monedhë të huaj (37.1 % dhe 41.1% përkatësisht). Rënia e kredisë për të dy pozicionet (lekë: 20.0% dhe monedhë e huaj: 18.9%) u shoqërua me rritje të depozitave përkatëse (respektivisht, 20.6% dhe 23.7%).*

[17] *Pozicioni kreditor në lekë ra me 2.4% përkundër rënies së atij në monedhë të huaj me 2.2%.*

Grafik 4.1 Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve, miliardë lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(22) Duke u fokusuar tek individët rezidentë, gjatë periudhës u regjistrua ulje e kursimeve në formën e depozitave në valutë dhe zhvendosje drejt kursimeve e investimeve në lekë, në aktive të tjera të sistemit financiar. Kështu, pesha e depozitave në valutë ndaj totalit të aktiveve të individëve rezidentë në sistemin financiar zbriti në nivelin 39.2%, ndërsa peshat e investimeve në bono thesari, në obligacione dhe në fonde investimesh kanë shënuar rritje gjatë periudhës (Tabela 4.1).

Tabela 4.1. Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar

	2010		2013		2016, qershor		2016, dhjetor		2017, qershor	
	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %
Depozita në lekë	357.6	49.8	449.5	43.7	450.4	40.3	454.3	40.3	465.1	42.1
Depozita në valutë	304	42.3	418.4	40.7	455.6	40.8	476.4	42.3	432.8	39.2
Bono thesari	56.7	7.9	70.6	6.7	72.4	6.5	65.2	5.8	67.3	6.1
Obligacione	0.37	0.05	39.8	3.9	66.4	5.9	64.5	5.7	67.9	6.1
Fondet e investimeve*	-	-	50.3	4.9	71.7	6.4	65.4	5.8	70.8	6.4
Fondet e pensioneve private vullnetare*	0.12		0.43	0.04	1.1	0.1	1.2	0.1	1.3	0.1
Portofoli i individëve	718.8	100	1,029	100	1,117.60	100	1,127.00	100	1,105.20	100.00

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe AMF.

4.1.1 KREDITIMI I INDIVIDËVE DHE RREZIKU I KREDISË

(23) Gjatë periudhës, zgjerimi i kredisë për individë i atribuohet kryesisht monedhës vendase, në kushtet kur kredia në valutë është zgjeruar lehtësisht. Si rrjedhim, pesha e kredisë në lekë për individët është ngjitur në 55.2%, rreth 3.3 pp më shumë se në qershor 2016. Tek kredia në valutë, vlera e kredisë së pambrojtur në valutë dhënë individëve ka rënë gjithashtu në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë, duke ulur ekspozimin ndaj lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Pesha e kredisë së pambrojtur në valutë ndaj tepricës totale të kredisë në valutë dhënë individëve zbriti në 53.0%, krahasuar me 55.1% dhe 53.9% në qershor dhe dhjetor 2016[18]. Rreth 79% e kredisë së pambrojtur për individë përbëhet nga "kredia për blerje shtëpie", e cila gjatë harkut kohor njëvjeçar ka rënë me 3.3 pp. Sipas afatit të maturimit, në kredinë totale për individët, kredia afatgjatë paraqet një rritje të lehtë me rreth 1pp dhe arrin në nivelin prej 79.5% të portofolit; kredia afatshkurtër ka zbritur në 6.0% dhe ajo afatmesme zë 14.5% të portofolit, duke u ulur me rreth 0.4 pp përkatësisht.

[18] *Në të njëjtin kah janë dhe zhvillimet në peshën e kredisë së pambrojtur në valutë kundrejt tepricës totale të kredisë dhënë individëve. Ky raport paraqet rënie në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë. Konkretisht, ajo arrin në nivelin 23.7% në qershor 2017, kundrejt nivelit prej 26.9% dhe 25.7% përkatësisht në qershor dhe dhjetor 2016.*

Grafik 4.2 Struktura e kredisë për individët sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(24) Përmirësimi i cilësisë së portofolit të kredisë për individët ka vijuar, i ndikuar nga procesi i fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Raporti i kredive me probleme për individët zbriti në 9.4%, rreth 3.1 pp më i ulët se vitin e kaluar. Përmirësimi i cilësisë së kredisë është më i ndjeshëm për kredinë në valutë dhe për pjesën e saj që është e pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit. Raporti i kredisë me probleme në valutë për individët zbriti në nivelin 11.1%, duke shënuar një rënie vjetore dhe gjashtëmujore prej përkatësisht 2.3 dhe 1pp. Raporti i kredive me probleme për kredinë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit zbriti më tej, në nivelin 10.6%[19].

Grafik 4.3 Ndryshimi vjetor i Raportit të Kredive me Probleme për individët, pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(25) Gjatë periudhës, kredia dhënë individëve rezidentë vijoi të përshpejtohet, duke u zgjeruar si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë, me përkatësisht 3.7% dhe 2.5%. Ky zhvillim pozitiv është ndikuar kryesisht nga zgjerimi i kredisë për "mallra jo të qëndrueshme" dhe për "pasuri të paluajtshme", ku kjo e fundit përbën 64% të kredisë totale dhënë kësaj kategorie të individëve.

[19] *Ky raport shënonte vlerat 14.0% dhe 11.2% në fund të qershorit dhe dhjetorit 2016.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4.1. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet çdo gjashtë muaj, mbi një kampion rastësor prej 1,209 familjesh, ku rreth 55% e tyre jetojnë në zonat urbane dhe 45% në zonat rurale të vendit.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, numri i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rritje në terma vjetorë, mbështetur kryesisht nga punësimi në sektorin shtetëror. Niveli i të ardhurave të familjeve dhe niveli i shpenzimeve kanë qenë në rritje gjatë periudhës, por rritja e shpenzimeve ka rezultuar më e madhe, duke sjellë ngushtim të balancës financiare (të ardhura-shpenzime) të familjeve. Rreth 28% e familjeve deklarojnë se kanë hua për të paguar dhe kjo peshë ka rënë pak krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.

Në 38% të rasteve të huamarrjes, familjet i janë drejtuar burimeve formale (banka dhe institucione jobankare) në formën e produkteve të kredisë dhe në 62% të rasteve i janë drejtuar burimeve joformale, kryesisht në cash. Krahasuar me një 6-mujor më parë, kjo shpërndarje është zhvendosur disi në favor të huamarrjes formale kundrejt asaj joformale, si rezultat i rritjes së rasteve të huamarrjes nga bankat. Tre qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten: për konsum (40% e rasteve të huamarrjes), blerje/riparim prone (28% e rasteve) dhe zhvillim biznesi (13% e rasteve). Gjatë periudhës së vrojtuar, peshat e rasteve të huamarrjes për konsum dhe blerje prone kanë shënuar rënie.

Totali i tepricës së raportuar të huasë rezulton në rritje krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. Rreth 80% e saj është siguruar nga burime formale dhe 20% nga burime joformale dhe kjo strukturë ka mbetur e pandryshuar krahasuar me 6-mujorin e kaluar. Në përbërjen e tepricës sipas monedhës rezulton se 92% e saj deklarohet në lekë dhe vetëm 8% në valutë (kryesisht euro). Sipas qëllimit të përdorimit, rreth 56% e tepricës së huasë deklarohet për 'blerjen/riparimin e një prone', 23% për 'zhvillimin e një biznesi' dhe vetëm 10% për 'qëllime konsumi'.

Familjet huamarrëse vlerësojnë rënie të kështit të huasë gjatë periudhës referuese, duke reflektuar prirjen rënëse të normës së ponderuar të kredisë për individët. Shumica e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar gjatë periudhës, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë kryesisht përkeqësim. Shumica e familjeve (rreth 78%) nuk presin ndryshim të aftësisë paguese në gjysmën e dytë të vitit 2017, ndërsa pjesa tjetër ka pritshmëri optimiste.

Mundësia për të marrë hua në pjesën e dytë të vitit ka rezultuar nën nivelin e mesatares afatgjatë dhe me prirje rënëse, gjë që mund të sinjalizojë dobësim të kërkesës për kredi nga sektori i individëve.

4.1.2 KREDITIMI I BIZNESEVE DHE RREZIKU I KREDISË

(26) Kredia për bizneset përbën 66% të tepricës së kredisë dhënë nga sektori bankar dhe regjistron një rënie të lehtë vjetore. Brenda këtij portofoli, peshën kryesore e zë kredia për biznesin rezident, me 85%. Kjo e fundit u tkurr si në terma gjashtëmujorë ashtu edhe vjetorë, me përkatësisht 3.0% dhe 5%. Gjatë periudhës, tkurrja më e madhe ndodhi në tepricën e kredisë për "kapital qarkullues" dhe "blerje pajisjesh"[20]. Ndërsa, zhvillimet vjetore flasin për një rënie të stokut të kredisë edhe në kategorinë "investime për pasuri të paluajtshme". Në të kundërt, teprica e kredisë për bizneset jorezidente u zgjerua me 15.5% ndaj një viti më parë dhe rreth 2.1% gjatë periudhës.

(27) Në strukturën e kredisë totale për bizneset, pesha e kredisë në lekë është rritur, përkundër rënies së kredisë në valutë. Pesha e kredisë në valutë në totalin e kredisë së bizneseve zbriti në 62.2%, ose 2.1 pp më pak se një vit më parë. Rënie ka shënuar edhe teprica e kredisë së pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit, ndonëse pesha e saj në totalin e kredisë për bizneset ka mbetur pranë nivelit 26%[21]. Në strukturën e kredisë së pambrojtur të bizneseve, peshat e kredisë "për tregti", "për zhvillim të pasurive të paluajtshme" dhe "për zhvillim biznesi" ranë përkatësisht ne 46.3%, 9.0% dhe 10.0%.

Grafik 4.4 Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(28) Në stokun e kredisë për bizneset, kreditë dhënë për bizneset e mëdha dhe të mesme mbajnë peshën kryesore. Pesha e kredisë për bizneset e mëdha dhe të mesme ka shfaqur rritje, duke zënë përkatësisht 60.2% dhe 23.8% të totalit të kredisë për bizneset, ndërsa pesha e kredisë për bizneset e vogla ka

[20] *Më konkretisht, kredia për kapital qarkullues dhe blerje pajisjesh regjistron një rënie gjashtëmujore prej përkatësisht 10.0% dhe 3.9%.*

[21] *Pesha e saj në qershor dhe dhjetor 2016, është përkatësisht 26% dhe 27% të totalit të kredisë për bizneset.*

rënë në 16.1%. Gjatë periudhës, biznesi i vogël dhe i mesëm ka vijuar të rrisë peshën e kredisë afatgjatë, ndërsa biznesi i madh vijon të jetë i orientuar drejt kredisë afatmesme, duke regjistruar ndryshime të vogla në rënie në peshën e asaj afatgjatë. Sipas monedhës së kreditimit, vërehet se biznesi i vogël ka ulur peshën e kreditimit në monedhë vendase në favor të asaj të huaj; ndërsa, biznesi i mesëm dhe ai i madh kanë zgjeruar kredinë në lekë.

Grafik 4.5. Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 4.6. Ndryshimi vjetor i raportit të kredive me probleme për bizneset, në pikë përqindjeje



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(29) Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset, pothuaj në të gjithë përbërësit e saj, shënon një përmirësim të ndjeshëm në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë. Në qershor 2017, raporti i kredive me probleme për bizneset shënoi nivelin 19.4%, nga 23.0% në dhjetor 2016 dhe 24.4% një vit më parë. Raporti i kredive me probleme për kredinë në valutë ka ndjekur të njëjtën prirje, duke zbritur në 19.6% në fund të periudhës, ose 5.7 pp nën nivelin e një viti më parë. Cilësia e portofolit të kredisë së pambrojtur në valutë shënoi gjithashtu përmirësim të ndjeshëm vjetor dhe gjashtëmujor, e ndikuar kryesisht nga procesi i fshirjes së kredive të humbura. Në fund të periudhës, raporti i kredive me probleme për këtë kategori zbriti në 16.7%, nga 22.2% në fund të vitit 2016 dhe 26.3% një vit më parë.

HAPËSIRË INFORMUESE 4.2. REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet prej tetë vitesh, me një frekuencë gjashtëmujore. Vrojtimi i fundit u realizua në periudhën maj-qershor 2017, duke pasur në fokus zhvillimet në gjysmën e parë të vitit, ndërsa pritshmëritë i referohen gjysmës së dytë të vitit 2017. Në vrojtim, u përfshi një kampion i zgjeruar prej rreth 1,238 ndërmarrjesh të të gjitha përmasave, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Në fillim të vitit, ky kampion është rifreskuar për 10% të tij.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2017, konkurrenca vijon të konsiderohet nga të gjithë grupet e ndërmarrjeve si problemi kryesor në aktivitetin e tyre. Krahasuar me pjesën e dytë të vitit 2016, rëndësia e këtij faktori vlerësohet në rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Gjetja e tregut gjithashtu vlerësohet si një tjetër faktor i rëndësishëm kufizues për të tre grupet e ndërmarrjeve, veçanërisht për ato të vogla dhe të mesme. Problematikat lidhur me aksesin në financim janë vlerësuar në rritje për ndërmarrjet e vogla, ndërsa kostot e financimit janë vlerësuar në rënie për ndërmarrjet e mesme e të mëdha.

Ecuria e shitjeve vijon të vlerësohet në rritje gjatë gjashtëmujorit të parë 2017, për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla. Në linjë me ecurinë e shitjeve, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë vlerësuar rritje të rezultatit financiar gjatë periudhës. Ecuria pozitive e nivelit të shitjeve dhe të rezultatit financiar, është reflektuar edhe në zgjerimin e veprimtarisë së ndërmarrjeve, për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Në përgjithësi, pritshmëritë pozitive të ndërmarrjeve (mbi shitjet, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë), japin sinjale optimiste për ecurinë e tyre në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2017, thuajse gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura e kanë financuar veprimtarinë e tyre përmes shitjeve. Huamarrja si burim më vete apo i kombinuar është përdorur nga 29.9% e ndërmarrjeve të mëdha, 25.8% e ndërmarrjeve të mesme dhe 22.9% e ndërmarrjeve të vogla.

Rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve (438 ndërmarrje gjithsej) pohojnë që kanë një hua për të paguar. Kjo peshë ka rënë krahasuar me gjysmën e dytë të vitit 2016, e ardhur nga të tre grupet e ndërmarrjeve, por disi më e theksuar tek ndërmarrjet e mesme. Rreth 89.3% e totalit të ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se u janë drejtuar bankave për të siguruar hua. Kjo peshë arrin në 92.1% për totalin e burimeve formale (banka dhe institucione financiare jobanka). Burimet informale kanë zënë 7.9% të totalit të huamarrjes, ku peshë më të madhe ka huamarrja nga persona fizikë (2.8%).

Qëllimet kryesore të huamarrjes janë përballimi i shpenzimeve korrente dhe kryerja e investimeve afatgjata. Krahasuar me vrojtimin e kaluar, rezulton se pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për të kryer investime afatgjata, është rritur në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, ndërkohë që ka rënë lehtësisht për ndërmarrjet e vogla. Rreth 78% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 78.6% e atyre të mesme dhe 77.3% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë 2016, kjo peshë rezulton në rritje për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, por në rënie për ndërmarrjet e mesme.

Huamarrja e ndërmarrjeve kryhet në monedhën vendase për 47.2% të totalit të ndërmarrjeve. Huamarrja në monedhën evropiane zë peshën kryesore prej 49.4%, ndërsa ajo në dollarë amerikanë zë 3.3%.

Huamarrja e re gjatë gjashtëmujorit, deklarohet vetëm nga 10% e ndërmarrjeve të vogla dhe nga 11% e ndërmarrjeve të mesme e të mëdha.

Vlera e përgjithshme e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 79.4% të ndërmarrjeve huamarrëse. Të analizuara sipas madhësisë, rezulton që ngarkesa e borxhit është më e lartë tek ndërmarrjet e vogla, ku rreth 24.3% e tyre deklarojnë se vlera e huasë është e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit. Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (73.4%) deklarojnë se pagesa e huasë ndaj të ardhurave arrin deri në 20% dhe kjo peshë ka rënë krahasuar me periudhën e kaluar. Barra e pagesës së huasë duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku numri i ndërmarrjeve që raportojnë se pagesa e huasë e kalon 20% të të ardhurave, zë rreth 33% të totalit të grupit.

Procesi i huamarrjes nga bankat vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", ndërsa rëndësia e marrëdhënies me bankat vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme", për të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha). Më shumë se gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura (51.3%) kanë deklaruar se nuk ka asnjë mundësi që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm. Kjo peshë rezulton në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, por në rritje për ato të mesme. Për të tre grupet ka pasur një rritje të peshës së ndërmarrjeve që pohojnë se ka pak mundësi që të marrin një kredi në periudhën pasardhëse.

4.2 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

(30) Sektori bankar është i ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë ndaj zhvillimeve në tregun e pasurive të paluajtshme[22] që përfshijnë ecurinë e ofertës dhe kërkesës, vëllimin e shitjeve dhe ecurinë e çmimeve në treg. Sipas të dhënave të INSTAT-it për fundin e vitit 2016, në tregun e pasurive të paluajtshme u raportua një rritje e qenësishme e sipërfaqes dhe numrit të lejeve të ndërtimit për objekte banimi, ndërsa kostoja e ndërtimit vijoi prirjen rritëse të nisur që nga tremujori i dytë i atij viti. Në vijim, edhe të dhënat e sektorit bankar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 paraqesin një rritje të lehtë të tepricës së kredisë për pasuri të paluajtshme[23], të shoqëruar me rritje të normave të interesit të kredisë dhe përmirësim të lehtë të cilësisë së saj. Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie ra në 8.3%, nga 8.8% në dhjetor 2016 dhe 10.4% një vit më parë. Teprica e kredisë për ndërtim nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme

[22] *Ekspozimi në këtë rast përfaqësohet nga kredia e dhënë për, ose e garantuar me pasuri të paluajtshme; kredia dhënë kompanive të sektorit të ndërtimit; si edhe nga portofoli i pasurive të paluajtshme që është krijuar tek bankat si rezultat i marrjes së kolateralit në vijim të procesit të ekzekutimit të detyrimit.*

[23] *Prej vetëm 0.2%.*

kundrejt dhjetorit 2016, por ra me 1.6% ndaj një viti më parë, duke bërë që pesha e saj të ulet në nivelin e 13.6% të tepricës së kredisë së bizneseve, dukshëm poshtë nivelit prej rreth 20% të regjistruar gjatë harkut kohor 2007 – 2011.

(31) Në fund të periudhës, bankat raportuan një rritje të lehtë të kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, në nivelin 50% nga 49% gjashtë muaj më parë. Brenda kësaj ndarjeje, 67% e kredisë për individë dhe 43% e kredisë për biznese rezulton e kolateralizuar me pasuri të paluajtshme. Ky raport ka ardhur në rritje për individët, ndërsa për bizneset në rënie. Nga vrojtimi i aktivitetit kreditues të Bankës së Shqipërisë gjatë T2-2017 rezultoi se kërkesa e individëve për kredi për pasuri të paluajtshme ka shfaqur rritje të lehtë, ndërkohë që kushtet për miratimin e kredisë raportohen të lehtësuara për individët dhe disi më pak për bizneset[24].

(32) Norma mesatare e ponderuar e interesit për kredi për pasuri të paluajtshme[25] shënoi 4.5%, duke shfaqur një rritje të lehtë gjatë periudhës, por duke mbetur gjithsesi brenda prirjes rënëse të viteve të fundit[26]. Në të njëjtën linjë, kostoja relative e pagesës së kredisë[27] për blerje pasurie të paluajtshme është rritur, duke reflektuar kushte disi më të shtrënguara për blerjen e pronave të paluajtshme nga këndvështrimi i huamarrësit.

Grafik 4.7. Kredia për blerje të pasurisë së paluajtshme dhe kosto e pagesës së kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 4.8 Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[24] *Sipas Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues, T2-2017, bankat vlerësojnë se kërkesa e individëve për kredi është rritur lehtë për kredinë për blerje banese (balanca rezultoi lehtësisht pozitive, në 1.6%).*

[25] *Për të llogaritur këtë normë, bëhet peshimi i normës së interesit të kredisë për blerje pasurish të paluajtshme dhënë individëve me normën e interesit të kredisë për investime në pasuri të paluajtshme dhënë bizneseve.*

[26] *Mesatarja e normës së interesit për pasuri të paluajtshme gjatë viteve 2008-2013 ishte 8.7%.*

[27] *Kostoja relative e pagesës për blerje pasurie të paluajtshme është vlerësuar si diferencë midis normës së interesit të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe normës mesatare të rritjes së çmimit të banesave për katër tremujorët e kaluar. Në rast se kjo diferencë vjen në rritje, atëherë kostoja relative vlerësohet në rritje dhe anasjelltas.*

HAPËSIRË INFORMUESE 4.3. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2017

Vlerësimi i situatës në tregun e pasurive të paluajtshme bëhet përmes vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 agjentë imobiliarë dhe shoqëri ndërtimi, të cilët përfaqësojnë rreth 75-80% të popullatës së këtyre subjekteve për nga madhësia e aktivitetit. Banka e Shqipërisë realizon hartimin e pyetësorit si edhe hedhjen dhe përpunimin e rezultateve, ndërkohë që Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar.

Në vrojtim, në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve prej -11.6%, tregon së një numër më i madh agjentësh kanë dhënë përgjigje negative (më keq) sesa përgjigje pozitive (më mirë). Kjo vlerë është disi më negative në krahasim me atë të gjashtëmujorit të kaluar (-8.6%), duke reflektuar një përkeqësim të lehtë të vlerësimit të agjentëve për situatën e tregut. Siç pritet, i njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje gjatë periudhës, paraqet një vlerësim dukshëm më pozitiv; balanca neto e përgjigjeve mbi situatën e përgjithshme nga ana e subjekteve që kanë raportuar shitje është rreth +22%.

Në fund të periudhës, Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi shfaqet 5.3% më i lartë në krahasim me nivelin e periudhës bazë, që është viti 2013. Ky zhvillim është ndikuar nga rritja e çmimit të banesave jashtë kryeqytetit dhe nga rritja e çmimit të shitjeve në zonat e tjera. Nga ana tjetër, indeksi i çmimit në rang vendi është 7% më i ulët nga periudha e kaluar. Për Tiranën, indeksi ra lehtë kundrejt periudhës bazë me 2.2%, dhe me 16.7% ndaj periudhës paraardhëse. Për zonat bregdetare, agjentët kanë raportuar çmime mesatare më të ulëta sesa ato të periudhës bazë, por rreth 7% më të larta se gjashtëmujorin e kaluar.*

Agjentët raportojnë numër pothuaj të njëjtë banesash të regjistruara në librat e tyre; balanca neto mes atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre, është në vlera shumë të lehta pozitive. Për pronat tregtare, balanca neto është -3.8%, nga vlerat pozitive 2.6% në periudhën e kaluar. Numri i pronave të pashitura, si për banesat, ashtu edhe për godinat tregtare, ka shënuar rënie; balanca neto ishte pozitive, duke treguar më pak prona të pashitura, për herë të dytë radhazi që nga koha e fillimit të vrojtimit, pavarësisht se me vlera më të moderuara në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.

Koha mesatare e shitjes së pronave në rang vendi raportohet të jetë mesatarisht 10 muaj ose rreth 3.7 muaj më e shkurtër se në gjashtëmujorin e kaluar. Për Tiranën, subjektet e intervistuara kanë raportuar një kohë mesatare shitjeje prej 9.5 muajsh, ndjeshëm më e ulët krahasuar me 13.8 muaj të raportuar në gjashtëmujorin e kaluar. Për zonën e bregdetit, koha e shitjes është rritur nga 8.4 muaj në rreth 11.7 muaj, ndërsa për zonat e tjera, subjektet kanë raportuar rënie të qenësishme të kohës së shitjes me periudhën paraardhëse; nga 15 muaj në 9.7 muaj.

Sipas agjentëve, rreth 72% e pronave për banim dhe për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Kjo shifër shënon rritje të lehtë në krahasim me vlerën prej 68% të raportuar në periudhën paraardhëse. Pjesa e çmimit të shitjes së pronës që është mbuluar me kredi (LTV) vlerësohet rreth 64%, më e lartë nga 53% në krahasim me periudhën e mëparshme.

Agjentët janë optimistë për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër dhe ndjeshëm më pozitivë për periudhën afatgjatë (deri në dy vjet). Numri i pronave që pritet të regjistrohen për shitje gjatë periudhës në vazhdim, pritet të shënojë rënie. Agjentët presin rritje të çmimeve të pronave të paluajtshme. Balanca neto ishte pozitive (11.4%) çka përbën pritjen më pozitive që nga fillimi i këtij vrojtimi.

* *"Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së bregdetit.*

5. TREGJET FINANCIARE

5.1 TREGU I LETRAVE ME VLERË

Grafik 5.1 Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(33) Gjatë periudhës, normat mesatare të interesit për titujt e borxhit të qeverisë shënuan rritje si në terma gjashtëmujorë ashtu edhe vjetorë. Në fund të gjashtëmujorit të parë, norma mesatare e interesit të borxhit të qeverisë ishte 2.9% ose 0.5 pp më e lartë në krahasim me fundin e gjashtëmujorit të kaluar dhe 0.8 pp më e lartë ndaj një viti më parë. Normat e kthimit në ankandet e tregut primar të titujve të borxhit u rritën si rezultat i rritjes së normës së interesit të bonove të thesarit. Këto të fundit vijojnë të mbizotërojnë strukturën e borxhit të brendshëm në Lekë, duke zënë rreth 70% të tij. Borxhi i brendshëm në Lekë i emetuar gjatë gjashtëmujorit të parë ishte rreth 190 miliardë lekë, 36% më i lartë në krahasim me borxhin e emetuar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit të kaluar, por i krahasueshëm me vlerën e një viti më parë.

Grafik 5.2. Përbërja e borxhit të emetuar gjatë 2015-6M1 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(34) Emetimet dhe norma mesatare e interesit të borxhit afatshkurtër të qeverisë shënuan rritje në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Emetimet e titujve të borxhit të qeverisë në formën e bonove të thesarit ishin rreth 130 miliardë lekë, ose rreth 30% më shumë sesa në gjashtëmujorin e kaluar, por 12% më pak ndaj vlerës së një viti më parë. Brenda borxhit afatshkurtër, bonot me afat maturimi 12-mujor përbëjnë rreth 83% të totalit. Norma mesatare e interesit të bonove të thesarit për të 3 maturitetet është rritur me 0.5 pp nga gjashtëmujori i kaluar dhe me 0.8 pp ndaj një viti më parë, duke arritur në nivelin 2.4%. Në disa ankande të bonove të thesarit, dhe kryesisht për ato 6-mujore, oferta për investim ka qenë më e ulët nga kërkesa për huamarrje ose shuma e shpallur nga qeveria, për shkak të rënies së normës së kthimit për këtë maturitet. Në vijim të preferencës më të lartë nga ana e investitorëve, interesi i bonove 12-mujore ka rënë nga 3.3% në ankandet e fillimvitit në 2.2% në fund të muajit qershor.

Grafik 5.3. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6M I - 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 5.4 Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6M I - 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(35) Vlera e borxhit afatgjatë të qeverisë të emetuar gjatë periudhës ka qenë më e lartë në krahasim me një gjashtëmujor më parë, ndërsa norma mesatare e interesit nuk ka shënuar ndryshime të konsiderueshme. Emetimet e titujve të borxhit në formën e obligacioneve ishin rreth 55 miliardë lekë, ose 60% më shumë se në gjashtëmujorin e kaluar dhe 5% më shumë ndaj të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rreth 77% e vëllimit të obligacioneve të emetuara përbëhet nga obligacionet me afat maturimi 2 dhe 5–vjeçare, me normë interesi të fiksuar. Norma mesatare e ponderuar e interesit të obligacioneve në Lekë për gjashtëmujorin e parë ishte 4.1%, 0.1 pp më shumë se në gjashtëmujorin e kaluar dhe 0.5 pp më shumë se një vit më parë. Rritja e normës së ponderuar të interesit të obligacioneve në Lek gjatë pjesës së dytë të vitit 2016 u reflektua në rritjen e kërkesës për investim në këta tituj gjatë gjashtëmujorit të parë

Grafik 5.5 Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 5.6 Vëllimi dhe norma mesatare e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 5.7 Huamarrja e brendshme në euro



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

2017. Në përgjithësi, shuma e ofruar për investim në ankandet e emetimit të obligacioneve ka qenë më e lartë sesa shuma e kërkuar nga qeveria, megjithatë në disa ankande, në të cilat është vërejtur një prirje në rënie e normës së interesit, oferta për investim ka qenë më e ulët sesa kërkesa për huamarrje.

(36) Në fillim të vitit, qeveria riemetoi në tregun e brendshëm borxh afatmesëm në Euro në formën e obligacioneve 2-vjeçare. Ky ishte emetimi i vetëm në euro për gjysmën e parë të vitit 2017, dhe përfaqëson rreth 3% të borxhit të brendshëm të emetuar gjatë periudhës. Borxhi në euro i emetuar në janar të këtij viti ishte rreth 39 milionë euro, 13% më i lartë sesa vlera e emetuar gjatë gjashtëmujorit paraardhës. Kërkesa më e lartë e qeverisë për huamarrje të brendshme në monedhën euro, u shoqërua me rritjen e normës së interesit të titullit në 0.80% nga 0.75%, që ishte norma e regjistruar në gjashtëmujorin e kaluar.

5.2 TREGU NDËRBANKAR

Grafik 5.8 Normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(37) Gjatë periudhës, vëllimi mesatar i transaksioneve në tregun ndërbankar shënoi rënie në krahasim me një gjashtëmujor më parë, ndërkohë që normat e interesit qëndruan pranë nivelit të normës bazë të interesit. Mbajtja e pandryshuar e normës bazë gjatë periudhës ka favorizuar nivele të ulëta të normave të interesit në tregun ndërbankar. Bankat kanë tregtuar përgjithësisht në vëllime më të ulëta, me norma interesi që kanë qenë vazhdimisht nën ose pranë nivelit të normës bazë të interesit, duke reflektuar një situatë të qëndrueshme të likuiditetit. Në gjashtëmujorin e parë, norma mesatare e interesit për transaksionet ndërbankare me afat 1-ditor mbeti e pandryshuar ndaj mesatares së gjashtëmujorit të kaluar në nivelin 1.20%. Norma mesatare e interesit për transaksionet 7-ditore ishte 1.19%, ose 0.03 pp më e ulët nga norma mesatare e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2016. Vëllimi mesatar i huamarrjes 1-ditore shënoi një rritje prej 1.7% ndaj gjashtëmujorit të kaluar. Pavarësisht normave të ulëta të interesit ndërbankar, vëllimi mesatar i transaksioneve 7-ditore shënoi rënie në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Rënie gjatë kësaj periudhe ka regjistruar edhe huamarrja me afat maturimi 1-mujor, megjithatë ky instrument përdoret rrallë dhe në vëllime më të vogla në krahasim me instrumentet e huamarrjes me afat më të shkurtër.

5.3 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

(38) Gjatë periudhës, leku u mbiçmua ndaj monedhës evropiane dhe ndaj dollarit amerikan. Në krahasim me fundin e muajit dhjetor 2016, në fund të periudhës, leku shfaqej i mbiçmuar me rreth 2.0% ndaj monedhës Euro dhe me rreth 10.2% ndaj monedhës amerikane. Zhvillimet në kursin Lek/Usd përgjithësisht kanë reflektuar ecurinë e kursit të dollarit amerikan në tregjet ndërkombëtare. Në terma mesatarë gjashtëmujorë, në krahasim me një vit më parë, monedha vendase është mbiçmuar me 2.5% ndaj euros dhe me 0.6% ndaj dollarit amerikan.

Grafik 5.9 Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE

(39) Gjatë periudhës, infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan gjatë periudhës 61,756 pagesa me një vlerë prej 4,375 miliardë lekësh, përkatësisht 6.5% dhe 33.7% më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Paralelisht, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës janë kleruar 259,364 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 176,000 lekësh. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje si në numër, ashtu edhe në vlerë me përkatësisht 11.12% dhe 12.49%.

Grafik 6.1 Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH, për gjashtëmujorin e parë 2016-2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(40) Në lidhje me instrumentet e pagesave, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 janë kryer rreth 6.3 milionë pagesa me një vlerë totale prej 2,310 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje të numrit të transaksioneve me 10.2% si dhe një rritje në vlerë me 8.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Transfertat e kreditit vijojnë të mbizotërojnë në instrumentet e pagesave, por pesha e këtij instrumenti ka rënë diktuar nga rënia në numër dhe në vlerën e këtyre instrumenteve në formën letër dhe jo-letër (*internet banking, mobile banking*).

Grafik 6.2 Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7. SISTEMI FINANCIAR

(41) Gjatë periudhës, pesha e veprimtarisë së sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) vlerësohet në rënie, por treguesit kryesorë financiarë përgjithësisht u përmirësuan. Në rënien e peshës së sistemit financiar, ndikoi kryesisht rënia e peshës së aktivitetit bankar. Sektori jobankar ka ruajtur peshën ndaj PBB-së, dhe në veprimtarinë e tij kanë kontribuar pozitivisht institucionet financiare jobanka, fondet private të pensioneve dhe fondet e investimeve. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar në sektorin jobankar vlerësohet i ulët, ndërkohë që performanca e sektorit bankar mbetet me rëndësi kritike për aktivitetin dhe qëndrueshmërinë e sektorit jobankar. Në strukturën e aktiveve të sektorit jobankar, investimet në titujt e borxhit të qeverisë shqiptare mbeten të rëndësishme dhe shfaqen në rritje për gjysmën e parë të vitit 2017. Veçanërisht për sektorin bankar, treguesit e kapitalizimit, të përfitueshmërisë dhe të likuiditetit qëndruan në nivele të kënaqshme.

Tabelë 7.1 Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	2011	2012	2013	2014	2015	2016	6ml-2017
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	84.7	89.6	90.5	91.7	91.3	94.9	91.9
	Institucione jobanka	2.5	2.7	2.5	2.7	2.7	2.9	2.8
	SHKK dhe unionet e tyre	0.7	0.8	0.8	0.8	0.7	0.6	0.5
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.5	1.6	1.6	1.7	1.9	2.1	1.9
	Fondet e pensionit	0.01	0.02	0.03	0.04	0.1	0.1	0.1
	Fondeinvestimi		1.21	3.7	4.5	4.7	4.4	4.7
Ndërmjetësimi financiar	89.41	95.93	99.13	101.44	101.3	105.1	101.9	

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

(42) Zhvillimet në aktivitetin e sektorit bankar, shoqërive të kursim-kreditit dhe shoqërive të sigurimit dhanë kontributin kryesor në rënien e peshës së veprimtarisë së sistemit financiar ndaj PBB-së. Pesha e totalit të aktiveve të sektorit bankar zbriti në 91.9% të PBB-së, kundrejt 94.9% në fund të vitit 2016. Struktura e aktiveve të sistemit financiar mbizotërohet nga bankat, aktivet e të cilave zënë rreth 89.7% të aktiveve të sistemit. Gjatë periudhës, ky mbizotërim ka shënuar rënie. Si rezultat i mbizotërimit të sektorit bankar në sistemin financiar, raporti i aktiveve të sistemit financiar[28] ndaj PBB-së ra në nivelin 101.9%, rreth 3 pp më poshtë se në fund të vitit 2016. Në terma vjetorë, veprimtaritë e sektorit bankar, të institucioneve financiare jobanka dhe të fondeve private vullnetare të pensionit, tregojnë rritje.

Grafik 7.1 Rritja vjetore e aktiveve të segmenteve përbërës të sistemit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

7.1 ZHVILLIMET NË SEKTORIN JOBANKAR

Institucionet që mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë

(43) Gjatë periudhës,institucionet financiare jobanka (IFJB) shënuan zgjerim të aktivitetit dhe tregues të mirë të performancës financiare. Konkretisht, rritja e aktiveve u mbështet nga zgjerimi i aktivitetit kreditues dhe i investimeve në tituj. Rezultati financiar i IFJB-ve ishte pozitiv dhe kapitalizimi i kënaqshëm, ndonëse cilësia e aktiveve ka shfaqur rënie. Në gjysmën e parë të vitit 2017, sistemi financiar përmbante 28 IFJB të angazhuara kryesisht në fushën e mikrokredisë, kreditimit, *leasing*-ut, faktoringut, parasë elektronike etj. Peshën kryesore e zënë IFJB-të që kryejnë aktivitet kreditues, ndjekur nga ato që kryejnë pagesa dhe transferta. Aktivet e IFJB-së shënuan 42.2 miliardë lekë, në rritje me 1.28% ndaj fundit të vitit 2016 dhe 6.5% ndaj një viti më parë. Peshën kryesore në strukturën e aktiveve e zënë "veprimet me klientë", që përfaqësojnë aktivitetin kreditues, ndjekur nga investimet në banka në formën e depozitave dhe llogarive rrjedhëse, të cilat kanë dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e aktiveve. Rreth 86% e portofolit të kredisë së IFJB-ve përbëhet nga bizneset, të cilat veprojnë kryesisht në sektorin e tregtisë (23.3%) dhe

Grafik 7.2 Struktura e institucioneve financiare jobanka sipas aktivitetit që kryejnë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[28] *Sistemi financiar përbëhet nga bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK), shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve suplementare, si dhe fonde të investimit. Në analizën e këtij kapitulli, konsideroni që vetëm të dhënat e sektorit bankar i takojnë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017. Të dhënat për segmentet e tjera të sistemit financiar i përkasin tremujorit të parë të vitit 2017.*

bujqësisë (13.9%). Rezultati financiar i IFJB-së rezultoi pozitiv, për rreth 0.14 miliardë lekë, por në rënie krahasuar me një vit më parë (0.34 miliardë lekë).

(44) Ecuria e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit (ShKK), ka qenë pozitive gjatë periudhës, por në krahasim me një vit më parë ajo është tkurrur. Rënia e investimeve në sektorin bankar dhe në aksione përcaktuan sjelljen e aktiveve të ShKK-ve. Veprimtaria kryesore e këtyre institucioneve reflekton rritje, pavarësisht ecurisë së aktivitetit të përgjithshëm. Rezultati financiar i SHKK-ve u kthye në terma pozitivë (rreth 17 milionë lekë) në krahasim me humbjen financiare të një viti më parë (rreth 40.6 milionë lekë). Kreditë për klientët, investimet në banka dhe aktivet e tjera (kryesisht investime në aksione) përfaqësojnë zërat kryesorë të aktiveve të këtyre institucioneve. Në gjysmën e parë të vitit, tregu kishte 13 shoqëri aktive të kursim-kreditit.

Grafik 7.3 Struktura e aktiveve të institucioneve financiare jobanka



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 7.4 Struktura e aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 7.5 Struktura e aktiveve të shoqërive të sigurimit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Institucione që mbikëqyren nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

(45) Aktiviteti i shoqërive të sigurimit u paraqit përgjithësisht i qëndrueshëm gjatë periudhës[29]. Në gjysmën e parë të vitit 2017, numërohen 12 shoqëri sigurimi të licencuara[30]. Aktivet e këtyre institucioneve qëndruan shumë pranë nivelit të fundit të vitit 2016, në rreth 29.3 miliardë lekë. Veprimtaria e tyre është e përqendruar kryesisht në investime në formën e depozitave me afat në banka, në tituj të borxhit të qeverisë dhe në aksione. Në tërësi, shoqëritë e sigurimit kanë ruajtur nivelet e kapitalit mbështetur nga një rezultat financiar pozitiv.

[29] *Të dhënat i takojnë T1 2017.*
[30] *8 shoqëri sigurimi të jojetës, 3 shoqëri sigurimi të jetës dhe 1 shoqëri risigurimi.*

Në veprimtarinë e sigurimeve, u vu re rritje e primeve të shkruara bruto dhe e pagimit të dëmeve. Të ardhurat nga primet (që paguhen në avancë) përdoren për pagesat e detyrimeve dhe mbulimin e kostove që mund të rrjedhin kur ndodh ngjarja e sigurimit. Primet e shkruara bruto[31], që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit, u zgjeruan me 12.0% në terma vjetorë. Treguesi i depërtimit të tregut të sigurimeve, i matur si raporti i primeve ndaj PBB-së, rezultoi 0.5%, duke ruajtur të pandryshuar nivelin e një viti më parë. Treguesi i humbjeve ose raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara bruto u rrit në 36.5% nga 28.4% një vit më parë. Ky zhvillim reflekton rritjen më të shpejtë të pagesave të dëmeve në krahasim me të ardhurat nga primet bruto. Vlera e dëmeve të paguara bruto u rrit me 44.0% në terma vjetorë në nivelin 2.7 miliardë lekë.

(46) Aktiviteti i fondeve të investimit[32] u zgjerua, si rezultat i rritjes së investimeve në banka dhe në titujt e borxhit të qeverisë. Fondi i investimeve është një sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur, e krijuar në bazë të një kontrate, nëpërmjet ofertës publike të kuotave[33], të cilat përfaqësojnë të drejtat ose interesat e investitorëve. Normat e kthimit nga pjesëmarrja e investitorëve në fondet e investimit është zakonisht më e lartë se ajo e depozitave në banka, duke reflektuar profilin më të lartë të rrezikut[34] që përmban investimi në fond. Në sistemin financiar shqiptar aktualisht veprojnë 3 fonde investimi. Aktivet e fondeve investohen kryesisht në bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në Lek dhe në Euro. Në vitin 2012, fondet e investimeve numëronin 7,149 anëtarë, ndërsa për periudhën, ky numër ishte rreth 4 herë më i lartë (31,235 anëtarë). Vlera e aktiveve neto në shtator 2012, rezultonte 16.9 miliardë lekë, ndërkohë që për 2017-ën, vlera neto e aktiveve ishte 70.8 miliardë lekë (4.7% e PBB-së së vendit).

Grafik 7.6. Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[31] *AMF, Buletini Statistikor "Tregu i Sigurimeve: Janar-Qershor 2017", publikuar më 25 korrik 2017.*

[32] *AMF, "Të dhëna të përgjithshme të Fondeve të Investimeve", 31 mars 2017.*

[33] *Ligji, nr.10 198, datë 10/12/2009 për "Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", AMF.*

[34] *Në një rast ekstrem që lidhet me lëvizjet e pafavorshme në treg dhe/ose keqmenaxhimin e një fondi, e tërë vlera e investuar nga investitori në një fond mund të humbasë. Në një rast të ngjashëm në banka, kursimet e depozituesit janë të mbrojtura të paktën deri në vlerën 2.5 milionë lekë (sipas parashikimeve në ligjin "Për sigurimin e depozitave). Në çdo rast, si fondet e investimit ashtu edhe bankat i nënshtrohen kërkesave rregullative për treguesit financiarë të veprimtarisë së tyre, me qëllim që mundësia e dështimit të tyre të jetë sa më e vogël.*

Grafik 7.7 Struktura e investimeve të fondeve të pensioneve private suplementare



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

(47) Edhe fondet e pensioneve private suplementare[35] kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre gjatë periudhës. Në Shqipëri veprojnë 3 fonde pensionesh private vullnetare. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2017, aktivet e këtyre fondeve shënuan vlerën 1.4 miliardë lekë ose 27% më shumë se një vit më parë. Aktiviteti i fondeve të pensionit dominohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë. Vlera e këtyre investimeve ishte rreth 1.3 miliardë lekë ose 5.8% më e lartë ndaj fundit të vitit 2016. Sipas raportimeve të fundit, numri i anëtarëve të fondeve të pensionit ishte 18,487.

7.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE EKSPOZIMEVE TË SEKTORIT JOBANKAR

(48) Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar në vend mbetet i ulët. Ky ekspozim, në krahun e aktivit të bankave përfaqësohet nga huatë dhe pjesëmarrja në kapitalin e institucioneve financiare jobankare, ndërsa në krahun e detyrimeve në formën e fondeve të mbledhura prej tyre (llogarive të ndryshme). Në total, ky ekspozim zë vetëm 2.3% të vlerës së aktiveve të sektorit bankar.

(49) Nga ana tjetër, ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë. Në total, ky ekspozim përbën 20.7% të aktiveve

Grafik 7.8 Ekspozimi i institucioneve kryesore jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përpunime nga Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.9 Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në titujt e qeverisë, ndaj totalit të aktiveve të tyre



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përpunime nga Banka e Shqipërisë.

[35] *AMF, Raporti Statistikor "Tregu i Pensioneve Private Vullnetare", 31 mars 2017, publikuar më 11 maj 2017.*

të sektorit jobankar, në rritje me 2.4 pp ndaj një viti më parë[36]. Shoqëritë e sigurimit dhe institucionet financiare jobanka (IFJB) shfaqin ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar pasi vendosjet e tyre në formën e depozitave dhe instrumenteve të kapitalit në banka, përbëjnë përkatësisht 33.9% dhe 25.2% të aktiveve përkatëse. Fondet e investimeve dhe shoqërive të kursim-kreditit paraqesin gjithashtu ekspozim në rritje.

(50) Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit duke qenë aktive në kredidhënie ekspozohen kryesisht ndaj rrezikut të kredisë. Në mars të vitit 2017, raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave tek IFJB-të shënoi rritje në 12.6% nga 11.9% një vit më parë, ndërsa për ShKK-të treguesi i cilësisë shënoi rënie në 5.4%, nga 8.2% një vit më parë.

(51) Rreziku i tregut është një rrezik që prek më ndjeshëm veprimtarinë e shoqërive të sigurimit të jetës, fondeve të investimeve dhe fondeve të pensioneve private suplementare. Mënyra e ndikimit është shpjeguar në numrin e kaluar të Raportit të Stabilitetit Financiar, dhe lidhet kryesisht me ndikimin që niveli apo lëvizjet në normën e interesit dhe në kursin e këmbimit, mund të japin në performancën financiare të shoqërisë për shkak të mospërputhjeve në maturim, në llojin e monedhës ose në profilin e pagesës së interesit, midis zërave të detyrimeve dhe të aktiveve në bilancin e këtyre shoqërive. Gjatë periudhës, normat e interesit kanë mbetur në nivele të afërta me periudhën e kaluar dhe kanë treguar përgjithësisht një luhatshmëri të ulët. Pas operimit për një kohë relativisht të gjatë në një mjedis me norma të ulëta interesi, potenciali i rritjes së tyre mund të shoqërohet me efekte negative në bilancin e këtyre institucioneve. Është e nevojshme që ky ndikim të provohet dhe të vlerësohet prej tyre në mënyrë të rregullt.

[36] *Të dhënat i referohen tremujorit të parë të vitit 2017.*

8. ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR

(52) Gjatë periudhës, zhvillimet në sektorin bankar kanë qenë pozitive pavarësisht se aktiviteti i përgjithshëm bankar është tkurrur. Veprimtaria e sektorit bankar u mbështet kryesisht në rritjen e investimeve ndërbankare, ndërkohë që investimet në tituj dhe kredia kanë rënë. *Sektori bankar u karakterizua nga një nivel i mirë kapitalizimi, likuiditeti dhe përfitueshmërie. Vazhdimi i procesit të fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave ka bërë që rritja e stokut të huave me probleme të vijë duke u ngadalësuar. Pavarësisht këtij zhvillimi, sektori bankar vijon të mbetet i ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit. Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kufizuar por ka nevojë të vlerësohet rregullisht.*

8.1 ECURIA E AKTIVITETIT BANKAR

(53) Veprimtaria e sektorit bankar është tkurrur gjatë periudhës, megjithatë ritmi i rritjes në terma vjetorë vijon të mbetet i lartë. Në krahasim me fundin e vitit 2016, aktivet e sektorit bankar ranë me 0.9% duke arritur në 1,394 miliardë lekë. Rënien më të madhe e ka shënuar zëri "Veprime me letra me vlerë"[37] kryesisht me subjekte jorezidente, ndjekur nga zëri "Veprimet me thesarin"[38]. Tkurrje është vërejtur edhe në aktivitetin kreditues. Kontribut pozitiv në ecurinë e aktiveve dhanë "Veprimet ndërbankare"[39], kryesisht në formën e depozitave me subjektet jorezidente. Në anën e pasiveve, zërat kryesorë vijojnë të mbeten "Veprimet me klientë", që përfaqësojnë aktivitetin depozitues dhe "Burimet e përhershme", që përfaqësojnë fondet e veta ose kapitalin e bankave. Titujt e borxhit të qeverisë shqiptare përfaqësojnë rreth 23% të totalit të aktivit nga 22%

[37] *Portofoli i investimeve në letrat me vlerë shënoi rënie me rreth 11.4 miliardë lekë ose 3.1% krahasuar me fundin e vitit 2016, duke zbritur në nivelin 356.9 miliardë lekë. Këto investime ishin kryesisht në formën e letrave me vlerë të vendosjes jorezidente në valutë, në nivelin 71.4 miliardë lekë, ose 24.7% më pak nga dhjetori 2016.*

[38] *Veprimet me thesarin dhe ndërbankare shënuan një rënie gjashtëmujore me rreth 9.5 miliardë lekë në nivelin 452.7 miliardë lekë. Kontributin kryesor në tkurrjen e këtij zëri e dha rënia e transaksioneve të bankave me Bankën Qendrore në formën e llogarive rrjedhëse. Ato ranë me rreth 24 miliardë lekë, në nivelin 33.4 miliardë lekë. Rënia e veprimeve me thesarin përcaktoi ecurinë e zërit "Veprime me thesarin dhe ndërbankare".*

[39] *Marrëdhëniet ndërbankare kanë dhënë kontribut pozitiv në ecurinë e aktiveve, duke u zgjeruar me rreth 20.3 miliardë lekë në nivelin 233.7 miliardë lekë, kryesisht në formën e depozitave në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare me subjekte jorezidente. Këto depozita u rritën me rreth 23.9 miliardë lekë, në nivelin 112 miliardë lekë.*

një gjashtëmujor më parë[40]. Në terma vjetorë, norma e rritjes së totalit të aktiveve të sektorit bankar shënoi vlerën 4.8%. Zgjerimi i aktiveve në terma vjetorë erdhi nga rritja në investimet ndërbankare dhe ato në letra me vlerë, kryesisht në tituj të borxhit qeveritar, por edhe në tituj të emetuar nga subjekte jorezidente.

Tabelë 8.1. Struktura e bilancit të bankave, qershor 2017

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor,%	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor,%
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	32.5	7.5	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	4.6	9.4
II. Veprime me klientët (Kredia)	42.9	-0.03	II. Veprime me klientët (Depozita)	81.7	3.5
Nga e cila: për sektorin publik	2.2	7.9	Nga të cilat: të sektorit publik	1.9	-10.3
Nga e cila: për sektorin privat	40.7	-0.4	Nga të cilat: të sektorit privat	79.7	3.9
III. Veprimet me letrat me vlerë	25.9	5.6	III. Veprimet me letrat me vlerë	0.5	921.5*
IV. Fonde rezervë të krijuara	-4.9	-13.6	IV. Detyrime të tjera	0.9	28.7
V. Të tjera**	3.6	6.2	V. Burimet e përhershme	12.2	6.8
			Nga të cilat: Borxhi i varur	1.6	-0.01
			Nga të cilat: Kapitali aksioner	9.9	8.3
Totali i aktiveve	100	4.8	Totali i pasiveve	100	4.8

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

* *Investime në letra me vlerë të blera dhe të shitura me REPO me jorezidentë, të cilat janë të përqendruara.*

***Tek zëri "Të tjera" në bilanc i referohemi "Mjeteve të tjera" dhe "Mjeteve të qëndrueshme".*

(54) Financimi i aktivitetit bankar sigurohet kryesisht nga depozitat, të cilat përbëjnë rreth 81.4% të totalit të aktiveve. Në qershor 2017, raporti hua/depozita shënon 52.5%. Stoku i depozitave ka shënuar rënie në terma gjashtëmujorë me rreth 1.6% dhe zgjerim në terma vjetorë me rreth 3.5%, ku kontributi kryesor ka ardhur nga sjellja e depozitave në valutë. Llogaritë rrjedhëse[41] vijojnë të japin kontributin kryesor në zgjerimin e bazës së depozitave. Ky zhvillim sinjalizon një dobësi potenciale përsa i takon strukturës së financimit të sektorit bankar, i cili megjithatë, zbutet deri diku nga fakti që 83.5% e depozitave mbahet nga individët dhe, në tërësi, afati mesatar i maturimit të detyrimeve ka ardhur në rritje për shkak të rritjes së stokut të depozitave me afat maturimi mbi 12 muaj. Bankat kanë ruajtur raportin e përdorimit të kapitalit të tyre për financimin e veprimtarisë, duke respektuar kërkesat përkatëse të kuadrit rregullativ.

(55) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një përqendrim i lartë për disa nga aktivitetet e tij. Në Grafikun 8.1 (majtas), tregohen produktet bankare (në aktiv dhe në pasiv të bankave), për të cilat sektori bankar paraqet një përqendrim të moderuar ose të ulët. Ndër to, për tregues si depozitat e përgjithshme apo kredia në lekë, shkalla e përqendrimit ka ardhur duke u ulur, ndërsa për kredinë për biznese përqendrimi ka shënuar rritje të dukshme që

[40] *E gjithë rritja e investimeve në tituj e borxhit të qeverisë erdhi nga zgjerimi i portofolit të obligacioneve. Në gjysmën e parë të vitit 2017, portofoli i bonove të thesarit u ngushtua me rreth 7.8 miliardë lekë krahasuar me dhjetorin 2016, në nivelin 61.2 miliardë lekë, ndërkohë që portofoli i obligacioneve shënoi rritje me rreth 14.7 miliardë lekë, në nivelin 255.4 miliardë lekë.*

[41] *Në qershor 2017, pesha e llogarive rrjedhëse rezultoi 32.3%, nga 28.5% në qershor 2016. Pesha e depozitave me afat ra në 57.5% nga 62.7% një vit më parë. Për periudhën kanë njohur zgjerim depozitat pa afat me rritje të peshës së tyre, në 8.3% nga 7.9%.*

nga gjysma e dytë e vitit 2015. Në Grafikun 8.1 (djathtas), tregohen aktivitetet për të cilat sektori bankar shfaq një përqendrim më të lartë, kryesisht në aktiv të bilancit të sektorit bankar. Tek këto përfshihen veprimet e huadhënies, kryesisht

Grafik 8. 1 Treguesi Herfindahl për produktet kryesore bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

me subjektet financiare jorezidente.

8.2 POZICIONI I SEKTORIT BANKAR NDAJ JOREZIDENTËVE

(56) Në kushtet kur financimi i veprimtarisë bankare vijon të mbizotërohet nga burime të brendshme, varësia e sektorit bankar nga burime të huaja financimi mbetet e kufizuar. Pozicioni neto i sektorit bankar ndaj jorezidentëve vijon të mbetet "kreditor" dhe ka ardhur duke u zgjeruar gjatë periudhës. Huamarrja nga grupet bankare vijon të jetë e ulët.

(57) Sektori bankar ka zgjeruar pozicionin kreditor ndaj subjekteve jorezidente. Në fund të periudhës, aktivet me jorezidentët përbëjnë 27% të totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve vetëm 5.9% të tyre. Si rezultat, pozicioni neto kreditor është zgjeruar me rreth 0.6% në terma gjashtëmujorë dhe rreth 11.7% në terma vjetorë, duke arritur në nivelin 294.5 miliardë lekë. Rritja më e madhe vjetore në transaksionet me jorezidentët në anën e aktivit, është evidentuar në klasat "Veprime me thesarin dhe ndërbankare" dhe "Veprime me klientë", së bashku për rreth 15.5%. Detyrimet ndaj jorezidentëve përbëhen në masën më të madhe nga "Veprimet me klientët" (depozita të jorezidentëve në bankat vendase), si dhe nga "Burimet e përhershme" ose fondet e veta. Gjatë periudhës është vërejtur rënie e zërit "Veprime ndërbankare", kryesisht depozitat dhe llogaritë rrjedhëse nga institucionet financiare jorezidente, çka tregon ulje të mëtejshme të burimeve të huaja të financimit.

Grafik 8.2 Kontributi i zërave në rritjen vjetore të aktiveve me jorezidentët, pp



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.3 Përbërësit e detyrimeve jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(58) Pretendimet në formën e vendosjeve[42] tek grupet bankare zotëruese përbëjnë vetëm 3.3% të aktivit të sektorit bankar, ndërsa pasivet për të njëjtin zë vetëm 0.01% të tyre. Vendosjet në grupet bankare zotëruese janë rritur me 2% në terma vjetorë. Rreth 56% e vlerës së vendosjeve është nga bankat e G3, 36% nga ato të G2 dhe rreth 9% nga bankat e G1. Sipas origjinës së kapitalit, grupi italian zë 34.3% të totalit, ndërsa ai grek zë 23.2% të vendosjeve në grupet bankare zotëruese.

(59) Masat me natyrë kundërciklike të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në maj të vitit 2013 kanë kontribuar në zbutjen e ritmit të rritjes së investimeve të sektorit bankar pranë subjekteve jorezidente, por ky ndikim ka ardhur në rënie. Në qershor 2017, ritmi vjetor i rritjes së investimeve të sektorit bankar pranë jorezidentëve prej rreth 9.1%, ishte dukshëm më i ulët në krahasim me ritmet e rritjes prej rreth 25% të këtyre investimeve në kohën kur filloi zbatimi i masave. Gjithsesi, pesha e aktiveve me jorezidentët, të cilat janë subjekt i masave kundërciklike u ngjit në 80% të totalit të aktiveve me jorezidentët, nga 78.6% një vit më parë. Brenda grupit të aktiveve me jorezidentët, që janë subjekt i masave të sipërpërmendura, vërehet një zgjerim i investimeve ndërbankare. Nga ana tjetër, ritmi vjetor i rritjes së aktiveve me jorezidentët, që nuk janë objekt i masave kundërciklike, ka qenë më i ulët duke shënuar vlerën prej 4.6% në qershor 2017. Në kushtet e kreditimit të ngadaltë dhe mungesës së alternativave të tjera të investimit, pavarësisht kërkesave më të larta për kapital që iu ngarkohen bankave për masën e ndryshimit të vendosjeve me jorezidentët, në muajin janar 2017, ritmi vjetor i rritjes së investimeve shënoi nivelin më të lartë historik që pas vitit 2013, rreth 21.6%. Ky zgjerim i konsiderueshëm u shfaq kryesisht në formën e rritjes në investimet ndërbankare dhe në investimet në tituj, dhe pasoi ndryshimin e mënyrës së zbatimit të masës

[42] *Nuk përfshihen investimet në tituj dhe kredia për subjektet jofinanciare jorezidente.*

rregullative në fund të vitit 2016[43]. Gjatë muajve në vijim, ritmet e zgjerimit të investimeve në subjekte jorezidente janë ulur gradualisht në nivelin 9.1%. Edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit 2017, Banka e Shqipërisë do të vijojë të zbatojë masat që synojnë uljen e investimeve në subjekte jorezidente, me qëllim nxitjen e vazhdueshme të kreditimit brenda vendit.

8.3 ZHVILLIMET NË KREDITIM

8.3.1 TEPRICA E KREDISË

(60) Gjatë periudhës, është vërejtur ulje e tepricës së kredisë në bilancin e sektorit bankar. Konkretisht, në fund të muajit qershor 2017, teprica e kredisë në bilancin e sektorit bankar shënoi nivelin 597 miliardë lekë[44], duke qenë rreth 0.5% më e ulët (ose 3.1 miliardë lekë) në krahasim me fundin e vitit 2016. Në krahasim me një vit më parë, teprica e kredisë ka mbetur pothuajse e pandryshuar. Në ecurinë e këtij aktiviteti gjatë periudhës dallohen rënia e ndjeshme e stokut të kredive me probleme (si rrjedhojë e shlyerjeve, ristrukturimit dhe pjesërisht e fshirjes së kredive të humbura), ecuria më e dobët e kredisë së re dhe efekti pakësues i mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut.

Tabelë 8.2. Ecuria e kredisë

	Treguesi dhe njësia	Vlera (mld lekë)	Pesha ndaj totalit të kredive (%)	Pesha ndaj totalit të kredive (%)	Ndryshimi	Ndryshimi
	Periudha	06/2017	06/2017	06/2016	Ndaj '12/2016	Ndaj '06/2016
Sipas valutës	Kredia në lekë	256,21	42.9%	39.9%	3.2%	7.4%
	Kreda në valutë	341,08	57.1%	60.1%	-3.1%	-5.0%
Sipas subjekteve	Sektori publik	30,44	5.1%	4.7%	6.2%	8.0%
	Biznese	393,49	65.9%	67.4%	-2.4%	-2.3%
	Individë	173,36	29.0%	27.9%	2.8%	4.2%
Sipas afatit	Afatshkurtër	185,10	31.0%	33.1%	-3.0%	-6.3%
	Afatmesëm	119,04	19.9%	18.7%	-2.0%	6.3%
	Afatgjatë	293,15	49.1%	48.2%	1.8%	1.8%
	Teprica e kredisë	597,28	100.0%	100.0%	-0.5%	0.0%

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(61) Sipas monedhave, gjatë periudhës është shënuar rënia me 3.1% (ose 11 miliardë lekë) e stokut të kredisë në monedhë të huaj dhe rritja me 3.2% (ose 7.9 miliardë lekë) e kredisë në lekë. Për shkak të peshës së konsiderueshme të kredisë në valutë (57%), ecuria e kursit të këmbimit të Lekut ndikon në vlerën nominale të kredisë së raportuar në monedhën vendase. Për tepricën e llogaritur në fund të muajit qershor 2017, vlerësimi i kursit të

[43] *Në fund të vitit 2016, Banka e Shqipërisë ndryshoi mënyrën e zbatimit të masës kundërciklike rregullative, ku për matjen e ndryshimit të investimeve me jorezidentët, nuk përdoret më një periudhë e fiksuar bazë (mars 2013), por u kalua në një periudhë kohe rrëshqitëse 2-vjeçare. Qëllimi i ndryshimit ishte vendosja e një kufiri të sipërm për rritjen e kërkesave të bankave për kapital, nga kjo veprimtari. Efekti i veçuar dhe i njëhershëm i këtij ndryshimi në bilancin e bankave pritej të shfaqej në formën e uljes së aktiveve të ponderuara me koeficientët e rrezikut dhe të përmirësimit të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.*

[44] *Duke përfshirë edhe interesat e përllogaritura. Pa këto, teprica e kredisë vlerësohet në rreth 593 miliardë lekë.*

këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore ka ndikuar në pakësimin e vlerës së raportuar të kredisë me rreth 8.7 miliardë lekë. Duke përjashtuar këtë efekt, teprica e kredisë gjatë periudhës do të ishte zgjeruar me 0.9% (nga rënia prej 0.5%), ndërsa kredia në valutë do të ishte ngushtuar me rreth 0.7% (nga rënia prej 3.1%). Në terma vjetorë, teprica e kredisë në monedhën vendase është zgjeruar me 7.4%, ndërsa ajo e kredisë në valutë është ngushtuar me 5%.

Grafik 8.4. Ecuria e kredisë sipas monedhave, rritje vjetore



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.5 Ecuria e kredisë sipas afatit, rritje vjetore



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(62) Kredia me maturitet afatshkurtër që përfaqëson 26% të tepricës së kredisë, ka dhënë kontributin kryesor në ngushtimin e tepricës së kredisë gjatë periudhës. Në krahasim me fundin e vitit 2016, kredia afatshkurtër dhe ajo afatmesme u tkurrën me përkatësisht 3% dhe 2%, ndërsa ajo afatgjatë u rrit me 1.8%. Në harkun kohor të një viti, kredia afatshkurtër ra me 6.3%, ndërsa kredia afatmesme dhe ajo afatgjatë u rritën përkatësisht me 6.3% dhe me 1.8%.

(63) Kredia për bizneset, e cila përbën peshën kryesore të tepricës së kredisë (rreth 66%), është ngushtuar gjatë periudhës me 2.3%, duke zbritur në 393.5 miliardë lekë. Rënia ka ardhur nga zvogëlimi i stokut të kredive me probleme, si rrjedhojë e fshirjeve të kredive të humbura, shlyerjeve të kredive me probleme dhe ristrukturimit të kredisë. Kredia për bizneset rezidente, e cila përbën 85% të kredisë dhënë bizneseve, është ngushtuar gjatë periudhës me rreth 3% (ose rreth 10 miliardë lekë), ndërsa kredia për bizneset jorezidente u zgjerua me 1.3% dhe në fund të periudhës shënoi nivelin 59 miliardë lekë. Kredia e marrë nga sektori publik zë vetëm 5% të kredisë së përgjithshme dhe kjo kredi u rrit me 6.2% gjatë gjashtëmujorit. Në terma vjetorë, kredia për bizneset është ngushtuar me 2.3% (rreth 9.4 miliardë lekë) dhe kjo ecuri ka reflektuar veprimet për mbledhjen dhe ristrukturimin e kredive, si edhe për largimin nga bilanci të kredive të humbura. Gjatë 12 muajve të fundit, janë fshirë rreth 7 miliardë lekë kredi të klasifikuara "të humbura", të marra nga subjektet 'biznes'. Në terma vjetorë, edhe kredia për sektorin publik është rritur me 8.3% (ose me 2.2 miliardë lekë).

(64) Kredia për individët u rrit me 2.8% (ose me 4.7 miliardë lekë) mbështetur nga zgjerimi i kredisë së re për subjektet rezidente. Kredia dhënë individëve rezidentë zë 95% të kredisë totale për individët dhe është zgjeruar me 2.5% (ose 4 miliardë lekë) gjatë periudhës. Kjo ecuri është ndikuar kryesisht nga zgjerimi i kredisë konsumatore me 5.2% dhe i kredisë hipotekare[45] me 1.1%. Kredia për individët jorezidentë u zgjerua me 7.3% gjatë periudhës. Në terma vjetorë, teprica e kredisë totale për individë është zgjeruar me 4.2% (ose 7 miliardë lekë). Zgjerimi i kredisë për individët është ndikuar nga mbështetja me kredi të re kryesisht për konsum.

Grafik 8.6 Ecuria e kredisë sipas qëllimit të përdorimit, rritje vjetore (boshti djathtas) dhe ndryshimi mujor i stokut (boshti majtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.7 Ecuria e kredisë për jorezidentët



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(65) Sektori bankar ka vijuar të financojë subjektet jorezidente (biznese dhe individë). Pesha e kredisë dhënë subjekteve jorezidente është ngjitur në 11.6% të tepricës së kredisë së sektorit bankar në muajin qershor 2017, nga 10% një vit më parë. Teprica e kredisë për jorezidentët shënoi nivelin 69 miliardë lekë, dhe u rrit me 2.1% gjatë periudhës dhe 15.5% ndaj një viti më parë. Kontributin kryesor në këtë rritje e ka dhënë kredia për bizneset jorezidente, e cila është rritur me 1.3% gjatë periudhës dhe 15.8% ndaj një viti më parë, duke zënë 85% të totalit. Pothuajse e gjithë kredia e dhënë për jorezidentët është në valutë, dhe kryesisht në monedhën euro. Në përgjithësi, kredia për jorezidentët është orientuar në afate më të gjata maturimi, me peshën kryesore në afatin e mesëm (54%) dhe atë të gjatë (me 31%). Kjo kredi është e përqendruar në një numër të vogël bankash.

[45] *Kjo kredi zë rreth 64% të tepricës së kredisë së marrë nga individët rezidentë.*

HAPËSIRË INFORMUESE 8.1. SEKTORI BANKAR DHE KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë, kryesisht të asaj të dhënë për bizneset, mbetet i lartë. Në qershor 2017, kredia në valutë e pambrojtur nga lëvizjet e kursit të këmbimit (kredia e pambrojtur në valutë) përbënte 45% të kredisë totale në valutë (0.3 pp më pak se fundi i vitit 2016 dhe 1 pp më shumë se një vit më parë) dhe 26% të tepricës totale të kredisë. Kredia e pambrojtur në valutë, si pjesë e kredisë së përgjithshme, ka rënë me rreth 1 pp si ndaj fundit të vitit të kaluar, ashtu edhe ndaj një viti më parë.

Teprica e kredisë së pambrojtur gjatë periudhës u ngushtua me 3.8% në nivelin 153.5 miliardë lekë, për shkak të ngushtimit të konsiderueshëm të kredisë së pambrojtur në monedhën amerikane, me rreth 41%. Sipas subjekteve, kredia për bizneset zë peshën kryesore (73%) të tepricës së kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit dhe rënia prej 5% e tepricës së kësaj kredie dha kontributin kryesor në ngushtimin e tepricës së kredisë së pambrojtur në valutë. Kredia e pambrojtur për individët u ngushtua me 2%. Në terma vjetorë, kredia e pambrojtur në valutë u ngushtua me 3.1%, dhe reflekton uljen e tepricës së kredisë së pambrojtur për të dyja llojet e subjekteve, por kryesisht të asaj për bizneset.*

Grafik 8.8 Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.9 Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas subjekteve, %



	12/13	03/14	06/14	09/14	12/14	03/15	06/15	09/15	12/15	03/16	06/16	09/16	12/16	03/17	06/17
Qeveria	0	0	0	0	0.0068	0.0073	0.0066	0.0066	0.0068	0.007	0.0061	0.0061	0.0059	0.006	0.0052
Biznes	0.7213	0.7231	0.7176	0.7257	0.7556	0.7126	0.7208	0.7135	0.7158	0.7093	0.7246	0.7255	0.7382	0.7405	0.7281
Individe	0.2787	0.2769	0.2824	0.2743	0.2376	0.2801	0.2792	0.2799	0.2774	0.2837	0.2694	0.2745	0.2618	0.2595	0.2667

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Të ndara sipas qëllimit të përdorimit, pjesa kryesore e kredisë së pambrojtur në valutë (rreth 44%) zihet nga kredia e dhënë për investime në pasuri të paluajtshme. Kjo lloj kredie ka ardhur duke rënë si në krahasim me fundin e vitit të kaluar (8%), ashtu edhe në krahasim me një vit më parë (11%). Rënia lidhet me rënien e shpejtë në stokun e kredive me probleme. Kredia në këtë formë është dhënë kryesisht për individët për "investime në pasuri të paluajtshme rezidenciale". Pjesa tjetër e kredisë së pambrojtur në valutë është dhënë kryesisht për tregti dhe zhvillim biznesi (Grafik 8.11).

Grafik 8.11Kredia e pambrojtur në valutë (jo për pasuri të paluajtshme)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.10 Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

* *Teprica e kredisë në usd ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, zë 12.5% të tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë.*

8.3.2 KREDIA E RE

(66) Gjatë periudhës, sektori bankar ka dhënë kredi të re në masën 128 miliardë lekë, ndërsa kredia e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë ishte 132 miliardë lekë. Kredia e re ishte rreth 9% më e ulët në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe rreth 13% më e lartë në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar. Vlera e kredisë së mbledhur ishte 12% më e ulët ndaj gjashtëmujorit të kaluar dhe rreth 23% më e lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Raporti i përdorimit të kredisë (kredi e mbledhur ndaj kredisë së re) shënoi nivelin 103% nga 107% në fund të vitit 2016 dhe 95% një vit më parë. Rritja vjetore e raportit të përdorimit të kredisë ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e zgjerimit të vlerës së kredive të mbledhura.

(67) Gjatë periudhës, ecuria e kredisë së re është përcaktuar nga ndryshimi i kredisë së re për sektorin publik. Në sektorin privat, bizneset kanë marrë rreth 77% të kredisë së re të periudhës, kryesisht në formën e kredisë 'Overdraft' (kredi afatshkurtër). Kredia e re për bizneset ishte më e lartë si në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar (4.5%) ashtu edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë (13%). Rritja ka ardhur si pasojë e rritjes së fluksit të kredisë në formën 'Overdraft' dhe të kredisë për kapital qarkullues. Edhe kredia e re për individët ka ardhur duke u rritur, kryesisht për shkak të rritjes së kredisë së re për blerje banesash, e cila zinte rreth 40% të saj. Në ndryshim nga një gjashtëmujor më parë, gjatë të cilit

kredia e re dhënë sektorit publik ishte sa rreth 13% e fluksit të kredisë së re, kredia për këtë sektor zuri vetëm një pjesë shumë të vogël të kredisë së re të dhënë gjatë periudhës (rreth 0.3%). Ngushtimi me 17.3 miliardë lekë i kredisë së re për këtë sektor ka ndikuar në ecurinë negative të kredisë së re në gjysmën e parë të vitit 2017. Ky efekt vlerësohet i përkohshëm, pasi kreditimi për sektorin publik, historikisht ka zënë peshë të vogël në fluksin e kredisë.

Grafik 8.12 Kredia e re sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(68) Sipas monedhës dhe afatit të maturimit, kontributin kryesor në ecurinë e kredisë së re gjatë periudhës e dha kredia në Lekë dhe ajo afatshkurtër. Kredia e re në Lekë ishte sa 53% e fluksit të përgjithshëm të kredisë së re. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit u dha rreth 20% (ose 17 miliardë lekë) më pak kredi e re në lekë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, por 15% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kredia e re në valutë ishte rreth 10% më e madhe në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Rreth 80% e kredisë së re në valutë përfaqësohet nga kredia në monedhën Euro, e cila ishte më e madhe në krahasim me atë të dhënë gjatë së njëjtës periudhë të një viti më parë. Sipas afateve te maturimit, kredia e re afatshkurter, e cila përbën 53% të totalit, ka dhënë kontributin kryesor në eurinë e kredisë së re gjatë periudhës. Kjo kredi, ndonëse është zgjeruar me 23% në terma vjetorë, paraqet një ngushtim prej 15% gjatë periudhës.

Grafik 8.13 Shpërndarja e kredisë së re sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

8.3.3 RREZIKU I KREDISË

(69) Gjatë periudhës, teprica e kredisë me probleme[46] ka rënë në mënyrë të ndjeshme. Në fund të periudhës, teprica e kredive me probleme ishte 93 miliardë lekë ose 15.2% më e ulët në krahasim me gjashtë muaj më parë. Rënia e stokut të kredive me probleme është rezultat i ristrukturimit të kredive me probleme, shlyerjes së kredive të prapambetura të bizneseve dhe fshirjes së kredive të humbura nga bilancet e bankave. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, nga bilancet e bankave janë fshirë rreth 4 miliardë lekë kredi të humbura, kryesisht të mbajtura nga bizneset në valutë. Kredia e ristrukturuar gjatë kësaj periudhe ishte rreth 6.2 miliardë lekë. Nga kjo vlerë, 1.7 miliardë lekë ishin kredi të klasifikuara si "me probleme" dhe pjesa tjetër ishin kredi "standarde" dhe kredi "në ndjekje". Në krahasim me një vit më parë, stoku i kredive me probleme është ngushtuar me 22% (ose 26.2 miliardë lekë). Gjatë periudhës korrik 2016 – qershor 2017, bankat kanë fshirë nga bilanci rreth 11 miliardë lekë kredi të humbura[47].

(70) Rënia e tepricës së kredisë me probleme, është shoqëruar me rënien e

[46] *Kreditë me probleme përfshijnë klasat "nënstandarde", "të dyshimta" dhe "të humbura". Kriter për të përcaktuar një kredi si "me probleme" është numri i ditëve të vonuara (90 ditë) dhe gjendja financiare e huamarrësit.*

[47] *Duke filluar nga janari 2015, bankat janë të detyruara nga kërkesat rregullative të ndërmarrin procesin e pastrimit të bilanceve – fshirjen e kredive që gjenden në kategorinë "e humbur" për më shumë se 3 vjet. Gjithsej, në dy vite e gjysëm, janë fshirë 43.3 miliardë lekë kredi të humbura.*

Grafik 8.14 Raporti i kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.15 Kontributi në ndryshimin gjashtëmujor të stokut të kredive me probleme (miliardë lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

ndjeshme të raportit të kredive me probleme (RKP). Në fund të periudhës, RKP-ja shënoi 15.6%, duke qenë rreth 2.7 pp më i ulët se ai i muajit dhjetor 2016, dhe 4.4 pp më i ulët nga niveli i një viti më parë. Brenda strukturës së kredive me probleme, si rezultat i shlyerjeve dhe ristrukturimeve, kreditë e kategorive "nënstandard" dhe "të dyshimta" janë ngushtuar me 15.6% dhe 32.8%. Kredia e klasifikuar "e humbur", e cila zë peshën kryesore ose rreth 60% të kredive me probleme është ngushtuar me 9.3% dhe rënia ka ardhur kryesisht si pasojë e largimit të tyre nga bilanci.

Grafik 8.16 Struktura e kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.17 Portofoli i kredive me probleme sipas grupeve bankare

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(71) Në përmirësimin e cilësisë së kredisë, kontributin kryesor e kanë dhënë

bankat e mëdha, të cilat së bashku kanë rreth 61% të tepricës së kredive me probleme. Kreditë me probleme për këtë grup bankash u ngushtuan me 17.2%, ndërsa RKP ra me 2.8 pp, në nivelin 14.9%. Bankat e mëdha (G3) kanë nivelin më të ulët të raportit të kredive me probleme, ndërsa bankat e vogla (G1), kanë nivelin më të lartë të RKP-së prej rreth 24.6%. RKP-ja për këtë grup ka rënë me 1.9 pp.

(72) Cilësia e kredisë paraqitet më e dobët për kredinë në valutë, kredinë për bizneset dhe kredinë me afat të gjatë maturimi. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, cilësia e kredisë për secilin portofol shënoi përkatësisht 17.6% (valuta), 19.5% (biznesi), dhe 17.0% (afati i gjatë). Të gjithë këta tregues kanë shënuar rënie gjatë periudhës.

(73) Cilësia e kredisë së pambrojtur në valutë ka ardhur në përmirësim të

Grafik 8.18 Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

vazhdueshëm që prej fillimit të vitit 2015. Raporti i kredive me probleme (RKP) për këtë kategori ra në nivelin 13.8% nga 19.3% që ishte në muajin dhjetor të vitit 2016, ndikuar nga rënia e shpejtë e stokut të kredive me probleme. Gjatë periudhës, teprica e kredisë së pambrojtur me probleme u ngushtua ndjeshëm, me rreth 31%. Sipas valutave, ndikimin kryesor në përmirësimin e cilësisë së kredisë së pambrojtur e dha kredia në Usd. Raporti i cilësisë për kredinë e pambrojtur në Usd u përmirësua me 16.6 pp, duke rënë në nivelin 7.8%, dhe RKP-ja për kredinë e pambrojtur në Euro u përmirësua me rreth 3.5 pp duke rënë në nivelin 14.7%.

Grafiku 8.19 Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(74) Sipas qëllimit të përdorimit, peshën kryesore në stokun e kredive me probleme brenda kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, e zë kredia për investime në pasuri të paluajtshme" (49%), e cila gjatë periudhës u tkurr me 29.3%. Kjo lloj kredie ka nivelin më të lartë të raportit të kredive me probleme, rreth 15.5%, e ndjekur nga ajo e dhënë për zhvillim biznesi me 15%. Gjatë periudhës, RKP-ja për këto dy kategori, ka rënë përkatësisht me 4.7 pp dhe me 12.6 pp. Nivelin më të ulët të RKP-së nga kategoria e kredive të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit e shfaq kredia konsumatore, me 3.8%. Ndërkohë që kredia konsumatore zë 3.2% të stokut të përgjithshëm të kredive të pambrojtura nga rreziku i kursit, pesha e kredive me probleme të kësaj kategorie në stokun e kredive me probleme të pambrojtura nga rreziku i kursit është rreth 1%.

(75) Cilësia e kredisë për subjektet jorezidente konsiderohet relativisht e

Grafiku 8.20 Ecuria e cilësisë së kredisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe ecuria e kredive me probleme për subjektet jorezidente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

mirë, pasi RKP-ja për këtë kredi shënon 3.5%, duke qenë dukshëm më i ulët në krahasim me RKP-në për tepricën e përgjithshme të kredisë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, stoku i kredive me probleme për jorezidentët është zgjeruar me 6.2%, duke arritur në nivelin 2.4 miliardë lekë, ndërsa raporti i kredive me probleme u rrit me 0.1 pp. Krahasuar me një vit më parë, RKP-ja është ngushtuar rreth 2.1 pp, ndërsa stoku i kredive me probleme është ngushtuar me 27.4%.

8.3.4 FAKTORË ZBUTËS TË RREZIKUT TË KREDISË

(76) Edhe pse vlera e provigjioneve për rrezikun e kredisë ka shënuar rënie, rënia më e shpejtë e stokut të kredive me probleme, ka sjellë rritjen e vlerës së raportit të mbulimit me provigjione në 72.5% (ose me 2.5 pp) gjatë periudhës. Krahasuar me një vit më parë, shumica e bankave të sistemit raportojnë njëkohësisht përmirësim të cilësisë së kredisë dhe nivel më të lartë të mbulimit me provigjione (grafik 8.21).

Grafik 8.21 Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.22* Ndryshimi vjetor në raportet e mbulimit për bankat - shigjetat tregojnë ndryshimin qershor 2016 - qershor 2017



*Shënim: Të përfshira bankat me peshë më të madhe se 1% ndaj totalit të aktivit. Ngjyra e gjelbër tregon përmirësim, ngjyra e kuqe përkeqësim dhe ngjyra blu një kombinim rreziku. Vija e ndërprerë shënon raportin mesatar të mbulimit me provigjion të kredive me probleme në nivel sektori, 72.5% në fund të qershorit 2017.

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(77) Rënia e vlerës së kredive me probleme neto[48] gjatë periudhës ka sjellë përmirësimin e mbulimit të tyre me kapital. Gjatë periudhës, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë është ngushtuar me 1.1 p.p, në nivelin 4.3%. Një vit më parë, ky raport shënonte 6.8%. Në të njëjtën kohë, si rrjedhojë e ekspozimit më të ulët ndaj rrezikut të kredisë përmes ngushtimit të tepricës së kredive me probleme neto, raporti "hua me probleme neto/kapitali rregullator" ra në 18.6% nga 23.1% në fund të muajit dhjetor 2016. Një vit më parë, ky raport shënonte 30.2%.

[48] *Kreditë me probleme neto përfaqësojnë vlerën e kredive me probleme që mbetet pasi zbriten provigjionet për këto kredi.*

(78) Mbulimi me kolateral i kredisë mbetet në nivele të larta dhe, midis llojeve të ndryshme të kolateralit të përdorur për të garantuar kredinë vijon të mbizotërojë pasuria e paluajtshme. Në qershor 2017, mbulimi me kolateral[49] shënonte nivelin 71.8% nga 71.2% në fund të vitit 2016 dhe 71% një vit më parë. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë rreth 70% të kredive të kolateralizuara, dhe 50% të tepricës së kredisë. Teprica e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme është rritur lehtë gjatë periudhës (me 0.6%), kryesisht për shkak të rritjes me 7% në tepricën e kredisë së kolateralizuar me pasuri të paluajtshme rezidenciale. Cilësia e kredisë së kolateralizuar është përmirësuar gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë, dhe RKP-ja shënoi nivelin 15.6%. Kredia e kolateralizuar me '*cash*' ka nivelin më të ulët të kredive me probleme (0.8%), ndërsa ajo e kolateralizuar me 'pasuri të paluajtshme – tokë' ka nivelin më të lartë të kredive me probleme (22.5%). RKP-ja për këtë lloj kredie ka ardhur duke u rritur. Cilësia e kredisë së pakolateralizuar, që zë rreth 28% të tepricës së përgjithshme të kredisë, ka ardhur duke u përmirësuar, gjë që është reflektuar në rënien e RKP-së në nivelin 15.5% nga 19.8% në fund të vitit të kaluar. Shkalla e lartë e përdorimit të pasurive të paluajtshme si kolateral për sigurimin e kredive të bizneseve dhe individëve, nxjerr në pah rëndësinë e mirëfunksionimit dhe rregullimit të tregut të pasurive të paluajtshme, si edhe të zbatimit në mënyrë transparente dhe eficiente nga të gjitha palët të detyrimit ligjor për ekzekutimin e detyrimeve, në rastet e mosshlyerjes së kredive.

Grafik 8.23 Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme sipas kolateraleve



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[49] *Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.*

8.4 DEPOZITAT DHE RREZIKU I LIKUIDITETIT

(79) Teprica e depozitave shënoi rënie gjatë periudhës, e ndikuar kryesisht nga efekti i mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut. Konkretisht, në qershor 2017, stoku i depozitave në sektorin bankar shënoi 1,138 miliardë lekë dhe gjatë periudhës (pra, në krahasim me fundin e vitit 2016), teprica e depozitave ka rënë me rreth 1.7% ose me rreth 19.1 miliardë lekë. Sipas monedhës, depozitat në lekë shënuan një rënie prej rreth 6.6 miliardë lekësh, ndërsa teprica e depozitave në valutë ra me rreth 12.6 miliardë lekë. Në ecurinë e depozitave në valutë gjatë periudhës, mbiçmimi i lekut ka dhënë një efekt negativ për rreth 17.3 miliardë lekë, duke kapërcyer vlerën nominale të rënies së tepricës së depozitave në valutë. Kjo do të thotë që depozitat në valutë, sipas transaksioneve në monedhat origjinale të tyre[50], të jenë rritur në total për rreth 4.5 miliardë lekë. Duke përjashtuar efektin e kursit të këmbimit, teprica e depozitave në total shënon një rënie shumë më të ulët gjatë periudhës, me rreth 2.2 miliardë lekë ose 0.2%. Në terma vjetorë, teprica e depozitave totale shënon rritje me 3.5%. Depozitat në valutë përbëjnë rreth 53% të tepricës së depozitave të sektorit bankar.

Tabelë 8.4. Tregues kryesorë të depozitave në sektorin bankar

	Treguesi dhe njësia	Vlera (miliardë lekë)	Pesha ndaj totalit të depozitave (%)		Ndryshimi	
	Periudha	06/2017	06/2017	06/2016	Vjetor	Gjashtëmujor
Sipas monedhës	Depozitat në lekë	540	47.4%	48.4%	1.5%	-1.2%
	Depozitat në valutë	599	52.6%	51.6%	5.4%	-2.1%
Sipas subjekteve	Sektori publik	28	2.4%	2.8%	-11.5%	-5.7%
	Biznese	160	14.1%	11.9%	22.2%	-1.5%
	Individë	951	83.5%	85.3%	1.4%	-1.6%
Sipas produktit	Llogari rrjedhëse	368	32.3%	28.5%	17.2%	-1.6%
	Depozita pa afat	95	8.3%	6.9%	24%	3.8%
	Depozita me afat	655	57.5%	62.8%	-5.1%	-2.2%
Stoku i depozitave		1,138	100.%	100.%	3.5%	-1.7%

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(80) Gjatë periudhës, depozitat e individëve dhe të bizneseve ranë përkatësisht me 1.6% dhe 1.5%. Duke qenë se depozitat e individëve zënë 83.5% të totalit të depozitave dhe gjysma e tyre është në valutë, ato qenë dhe kontribuesi kryesor në rënien e bazës së depozitave, me një ngushtim prej rreth 15 miliardë lekësh. Rënien më të shpejtë gjatë periudhës e regjistruan depozitat në valutë të individëve me 8.8 miliardë, përkundër rënies me vetëm 0.8 miliardë lekë të depozitave në valutë të bizneseve. Në terma vjetorë, depozitat e individëve dhe të bizneseve shënuan rritje me përkatësisht 1.4% dhe 22.2%.

[50] *Kjo përjashton efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit dhe pasqyron vetëm lëvizjet neto (hyrje – dalje) të depozitave sipas valutave origjinale.*

Grafik 8.24 Kontributi në ecurinë e depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(81) Depozitat me afat vazhdojnë të mbajnë peshën kryesore në vlerën totale të depozitave, por shënojnë tkurrje në terma absolutë dhe relativë ndaj stokut të depozitave[51]. Gjatë periudhës, depozitat me afat ranë me 14.5 miliardë lekë ose me 2.2%. Stoku i llogarive rrjedhëse ra gjithashtu, me rreth 6.1 miliardë lekë gjatë periudhës. Gjatë periudhës, depozitat pa afat ishin të vetmet që kontribuan në rritje të stokut të depozitave, në vlerën 3.5 miliardë lekë.

Grafik 8.25 Ecuria e depozitave sipas llojit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[51] *Nga muaji tetor i vitit 2013, kur rritja vjetore e depozitave me afat filloi të regjistronte norma negative, depozitat me afat kanë rënë me 17.2%, ndërsa pesha e tyre ndaj totalit të depozitave ka rënë nga 77% në 57.5%.*

(82) Rënia e depozitave gjatë periudhës është përqendruar në grupin e bankave të mëdha G3. Së bashku, ngushtimi i depozitave të G3 ishte më i lartë se rënia totale e bazës së depozitave të sektorit. Kjo evidenton rritjen e lehtë të depozitave (në agregat) në grupet e bankave të mesme dhe të vogla. Përqendrimi i depozitave sipas Indeksit Herfindahl qëndron poshtë niveleve të moderuara[52] (1,438 pikë) duke shfaqur një nivel të përshtatshëm përqendrimi.

(83) Gjatë periudhës, fluksi i depozitave të reja me afat në sektorin bankar ishte 243 miliardë lekë ose rreth 26% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorët e mëparshëm. Pesha e depozitave të reja me afat në totalin e depozitave të reja ka ardhur në rënie duke arritur në 16% nga 19% një gjashtëmujor më parë dhe nga 21% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016. Në kategorinë e depozitave të reja me afat, vërehet një zhvendosje e lehtë drejt maturiteteve më afatgjata. Fluksi i depozitave të reja në Lekë dhe Euro ra me përkatësisht 13%, dhe 12%, kurse ai në Usd u rrit me mbi 15%. Gjatë periudhës, normat mesatare të interesit për depozitat e reja me afat në Lekë kanë qëndruar në nivelin 0.9%, thuajse pa ndryshime nga periudha e kaluar, ndërkohë që normat e interesit për depozitat e reja me afat në Usd dhe Euro kanë shfaqur rënie të lehtë, në nivele përkatësisht 0.2% dhe 0.3%.

Grafik 8.26 Përbërja e depozitave të reja me afat sipas monedhës dhe afatit të maturimit, flukset gjashtëmujore



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

8.4.1 RREZIKU I LIKUIDITETIT

(84) Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar është në nivele të mira. Treguesit e likuiditetit, në lekë dhe valutë, janë mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator. Burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat mbulojnë gati dy herë vëllimin e kredive të sektorit.

52 *Vlerat e indeksit Herfindahl deri në 1500 tregojnë një treg konkurrues, vlerat 1500-2500 tregojnë një konkurrueshmëri të moderuar, dhe mbi 2500 një përqendrim të lartë.*

(85) Sektori bankar vijon të ruajë një pozitë të mirë likuiditeti me një tepricë të konsiderueshme të depozitave të klientëve mbi kreditë. Në qershor 2017, raporti "depozita/kredi" shënoi 190.6%. Sipas monedhës, ky raport shënon 211% për monedhën vendase dhe 176% për valutën.

(86) Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta, në vijim të një ecurie poshtë potencialit të aktivitetit kreditues. Në fund të muajit qershor 2017, aktivet likuide përbëjnë 31.1% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, lehtësisht në rënie gjatë periudhës me 0.2 pp. Ecuria e treguesit tjetër të likuiditetit "aktive likuide/totali i detyrimeve afatshkurtra" u rrit lehtësisht me 0.5 pp, në nivelin 41.1%. Ndonëse bankat po operojnë në kushtet e një likuiditeti të bollshëm, hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit të mbetur, në raport me totalin e aktiveve, konsiderohet në nivele të larta dhe në rritje kundrejt periudhave të kaluara në afatin e shkurtër.

Grafik 8.27 Tregues të likuiditetit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.28* Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve



*Janë përfshirë edhe aktivet dhe detyrimet jashtë bilancit.
Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(87) Gjatë periudhës është rritur diferenca mes afatit mesatar të maturimit të aktiveve dhe atij të detyrimeve. Kjo diferencë u vlerësua rreth 19.1 muaj në qershor 2017, nga 16.5 muaj në fund të 2016, duke përfaqësuar vlerën më të lartë që nga viti 2010. Maturiteti i mbetur i depozitave, si zëri më përfaqësues i detyrimeve është ngushtuar lehtë në 6.7 muaj gjatë periudhës. Maturiteti i mbetur i kredive nga krahu i aktiveve është zgjeruar në 45.5 muaj (nga 44.8 muaj në dhjetor 2016), duke reflektuar prirjen e bankave për të krediturar për periudha më afatgjata.

Grafik 8.29 Maturimi mesatar i mbetur



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(88) Vlera e linjave të financimit nga grupet bankare zotëruese zë një peshë shumë të ulët në burimet e financimit të sektorit bankar. Gjatë periudhës, totali i vlerës së këtyre linjave shënoi 8.7 miliardë lekë, nga 6.3 miliardë në fund të vitit 2016. Për bankat që disponojnë linja kredie me grupet bankare zotëruese në fund të periudhës, shkalla e përdorimit të tyre shënoi 16.3%, nga 29.6% në dhjetor 2016.

8.5 RREZIQET E TREGUT DHE AI OPERACIONAL

8.5.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

(89) Pozicioni i hapur neto valutor i sektorit bankar, është luhatur brenda niveleve afatgjata në raport me kapitalin rregullator, duke dëshmuar për një ekspozim të kufizuar dhe në rënie të sektorit bankar ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilanc nga luhatjet në kursin e këmbimit. Në fund të periudhës, pozicioni i hapur neto valutor "në blerje" i sektorit bankar ishte sa 5.6% e kapitalit rregullator, duke qenë 1.5 pp më i ulët se në dhjetor 2016 dhe 2.9 pp më i ulët se një vit më parë. Siç vërehet dhe nga grafiku 8.30, ecuria e treguesit për sektorin bankar është diktuar kryesisht nga grupi i bankave të mëdha. Këto të fundit, vijojnë të ruajnë pozicion të hapur valutor "në blerje" në nivelin 4.4% të kapitalit rregullator, por ky pozicion është mjaft më i ulët nga niveli prej rreth 12% dhe 11.4% i regjistruar respektivisht një vit dhe gjashtë muaj më parë. Grupi i bankave të mesme ka rritur ekspozimin valutor me 3.1 pp nga gjashtëmujori i kaluar, duke u pozicionuar "në blerje" në nivelin 1.2% të kapitalit rregullator, por nuk ka shënuar ndryshim në krahasim me një vit më parë. Grupi i bankave të vogla ka zgjeruar pozicionin e hapur valutor "në shitje" si ndaj gjashtëmujorit të kaluar, ashtu dhe ndaj një viti më parë në nivelin 11.4% të kapitalit rregullator.

Grafik 8.30 Pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(90) Gjatë periudhës, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit qëndron në nivele të përafërta me vlerat e fundit të vitit 2016. Në fund të qershorit 2017, treguesi i mospërputhjes valutore[53] për të gjitha monedhat, qëndroi në të njëjtin nivel me gjashtëmujorin e kaluar, 18.4% e aktiveve. Tkurrja e aktiveve në valutë me 2.8% është kompensuar nga rënia e kredisë në valutë për subjektet rezidente shoqëruar me tkurrjen e pasiveve në valutë. Gjithashtu, tkurrja e totalit të aktiveve të sektorit bankar ndaj gjashtëmujorit të

[53] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të pasiveve të sektorit bankar në valutë me aktivet në valutë (pasi prej këtyre të fundit zbritet kredia në valutë për rezidentët). Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj totalit të aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Për shpjegime më të detajuara të treguesit të mospërputhjes valutore, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

kaluar ka kontribuar në mbajtjen të pandryshuar të treguesit të mospërputhjes valutore. Mospërputhja valutore në Euro është rritur me 0.4 pp duke arritur në nivelin 17.8%, ndërsa ajo në dollarë amerikanë ka rënë me 0.5 pp duke zbritur në nivelin 0.8%.

Grafik 8.31 Mospërputhja valutore sipas përbërësve



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.32 Mospërputhja valutore sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(91) Për të tri grupet bankare, ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit nuk paraqet ndryshime ndaj gjashtëmujorit të kaluar, por vërehet prirje rënëse e tij kundrejt një viti më parë. Duke qenë se indeksi i mospërputhjes valutore është i lidhur me nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit, konstatohet se grupi i bankave të mëdha ka nivelin më të ulët të ekspozimit ose një shkallë më të lartë të mbulimit të detyrimeve valutore me aktive të netuara në valutë; ndërkohë që, bankat e mesme shfaqin ekspozimin më të lartë ose mbulimin më të

Grafik 8.33 Mospërputhja valutore sipas monedhave dhe grupeve



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.34 Mospërputhja valutore, sipas grupeve



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

ulët të detyrimeve valutore. Për këto grupe, indeksi i mospërputhjes valutore në fund të gjashtëmujorit të parë ishte përkatësisht 14.8% dhe 26.9%, ndërkohë që për bankat e vogla, indeksi shënoi vlerën 23.8%. Nga Grafiku 8.34 vërejmë se në 5-vjeçarin e fundit, ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka ardhur në rënie për grupin e bankave të mesme dhe bankave të mëdha, ndërsa bankat e vogla shfaqin luhatshmëri ndaj këtij ekspozimi.

8.5.2 RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

(92) Sektori bankar mbetet i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit në kushtet kur diferenca midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit, sipas periudhave të riçmimit, është në vlera relativisht të larta. Gjatë gjysmës së parë të vitit, sektori ka ulur ekspozimin ndaj luhatjeve të normës së interesit për periudhën afatshkurtër deri në 1 muaj dhe deri në 3 muaj, duke ngushtuar ndryshimin kumulativ midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit[54]. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ndryshimi midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit për maturitetin deri në 1 muaj, ra në nivelin 10.5% të aktiveve nga niveli 13.4% që mbante në dhjetor të vitit 2016; ndërsa, diferenca për maturitetin e mbetur deri në 3 muaj ra në nivelin 7.2% të aktiveve nga 16.1% në dhjetor 2016. Ndërkohë, diferenca "mjete – detyrime" për maturitetin e mbetur deri në 12 muaj u zgjerua me 1.2 pp, në nivelin 10.2% të aktiveve të sektorit bankar. Ulja e nivelit të hendekut mes mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit ul rrezikun që sektori bankar dhe banka të veçanta të përballen me kosto në rastin kur zhvillimet ekonomike sinjalizojnë një rritje të normave të interesit në treg. Vlerësimi i rrezikut që mund të vijë nga luhatjet e normave të interesit, përveç monitorimit të efektit të drejtpërdrejtë në rezultatin financiar të bankave (përmes ndikimit mbi të ardhurat neto nga interesi dhe mbi të ardhurat nga rivlerësimi), duhet të mbajë në konsideratë edhe efektin e tërthortë të lëvizjes së normës së interesit në aftësitë paguese të huamarrësve. Një rritje e mundshme e normës së interesit ndikon negativisht në aftësinë paguese të huamarrësve dhe mund të shoqërohet me probleme në cilësinë e kredisë.

Grafik 8.35 *Spread*-i i normave të interesit sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[54] *Duke filluar nga dhjetori 2016, në aktivet dhe pasivet e ndjeshme ndaj normës së interesit janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.*

8.5.3. RREZIKU OPERACIONAL

(93) Niveli i mbulimit me kapital për rrezikun operacional të sektorit bankar shfaqet i kënaqshëm dhe i qëndrueshëm për periudhën. Kërkesat për kapital për mbulimin e humbjeve operacionale kanë qëndruar në nivelin 85.3 miliardë lekë në fund të periudhës, duke ruajtur nivelin e fundit të vitit 2016. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit nuk është ndikuar nga rreziku i luhatjeve të humbjeve operacionale për periudhën.

Grafik. 8.36 Kërkesa për kapital për rrezikun operacional



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

8.6 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E BURIMEVE

(94) Sektori bankar raportoi rezultat financiar pozitiv, në rritje të ndjeshme kundrejt një viti më parë. Për shkak të rënies më të shpejtë të të ardhurave nga interesat krahasuar me ritmin e rënies së kostove të financimit, të ardhurat neto nga interesi dhe marzhi neto i interesave kanë shënuar rënie. Veprimtaritë e tjera ranë gjithashtu, kryesisht nga të ardhurat nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimet me valutat. Shpenzimet në formën e provigjioneve për rrezikun e kredisë ranë ndjeshëm dhe përfaqësojnë faktorin kryesor të rritjes së fitimit në sektorin bankar. Ky zhvillim është në linjë me ecurinë pozitive të portofolit të kredisë, ku ulja e ndjeshme e raportit të kredive me probleme ka kontribuar në këtë rezultat.

(95) Në fund të periudhës, sektori bankar raportoi një rezultat financiar pozitiv prej 11.5 miliardë lekësh ose rreth 6.4 miliardë lekë më të lartë sesa një vit më parë. Treguesit kryesorë të rentabilitetit, kthimi mbi aktivet (ROA) dhe

Grafik 8.37 Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.38 ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

kthimi mbi kapitalin (ROE), shënuan përkatësisht 1.6% dhe 16.7%, duke qenë përkatësisht 0.9 pp dhe 8.7 pp më të lartë në krahasim me një vit më parë. Grupi i bankave të vogla është i vetmi grup për të cilin vlerat e treguesve RoE dhe RoA kanë shënuar rënie.

(96) Ulja e vazhdueshme e kostove të financimit nuk mjaftoi për të kompensuar rënien e të ardhurave nga aktiviteti kryesor bankar. Kështu, rezultati neto nga interesat ra me rreth 1.1 miliardë lekë, në 22.4 miliardë lekë, pasi rënia e të ardhurave nga interesat rezultoi më e lartë sesa ajo e shpenzimeve për interesa. Si rrjedhojë, marzhi neto nga interesat gjithashtu tregoi rënie, në nivelin 3.9%, nga 4.2% një vit më parë.

Grafik 8.39 Marzhi neto nga interesi



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.40 Shpenzimet për provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(97) Shpenzimet për provigjionim shënuan 1.4 miliardë lekë ose 8.1 miliardë lekë më pak se një vit më parë, duke përfaqësuar faktorin kryesor pas rritjes së rezultatit financiar të sektorit. Shpenzimet për provigjionimin e kredive ranë me 6 miliardë lekë. Për bankat individuale, në kushtet kur rezultati neto nga veprimtaria bankare nuk ka shënuar ndryshime të rëndësishme ose ka regjistruar rënie, rënia e shpenzimeve të provigjionimit ka dhënë ndikimin kryesor në rritjen e rezultatit financiar. Pesha në aktivet e sektorit bankar e aktiveve të bankave që regjistruan humbje financiare ra ndjeshëm në nivelin 2%; praktikisht vetëm 3 banka të vogla raportuan humbje financiare, me vlera shumë të ulëta.

(98) Rezultati financiar nga veprimtaritë e tjera ra me rreth 1.7 miliardë lekë, si pasojë e rënies së të ardhurave nga veprimet me titujt dhe valutat. Në të njëjtën kohë, kostot e veprimtarisë, edhe pse shënuan rritje të lehtë, u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë, duke dhënë ndikim pozitiv në të ardhurat operative bruto (para provigjionimit). Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave ishte 52.9% dhe shfaqi një luhatshmëri të ulët vitet e fundit.

8.7 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

(99) Kapitalizimi i sektorit bankar në qershor 2017 vlerësohet i kënaqshëm dhe ecuria e tij u përcaktua nga tkurrja e ndjeshme e kërkesave për kapital për investimet në subjektet jorezidente. Kapitali rregullator shënoi rënie pavarësisht injektimit me kapital dhe një rezultati financiar pozitiv, ndikuar nga ulja e borxhit të varur dhe elementeve të tjera të kapitalit. Nga ana tjetër, tkurrja më e shpejtë e aktiveve të ponderuara me rrezik për shkak të rënies së aktiveve me rrezik për investimet në subjekte jorezidente, ka ndikuar në ruajtjen e një niveli të lartë të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Ky nivel qëndron ndjeshëm mbi normën minimale rregullatore të lejuar për bankat individuale dhe sektorin bankar në tërësi.

Grafik 8.41 Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(100) Në qershor 2017, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 16.3% nga 16.0% në fund të vitit 2016 dhe 15.8% një vit më parë. Në gjysmën e parë të vitit 2017, aktivet e peshuara me rrezik ishin rreth 5.3% më të ulëta krahasuar me muajin dhjetor 2016, duke kontribuar në rritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.9 pp. Nga ana tjetër, për shkak të uljes së borxhit të varur dhe elementeve të tjera të kapitalit (diferencat e rivlerësimit), kapitali rregullator ra me 3.5%, duke ndikuar në rënien e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me 0.6 pp.

Grafik 8.42 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(101) Në nivel grupesh, normën mesatare më të ulët të kapitalizimit e shfaqin bankat e G3, ndërsa sipas origjinës së kapitalit të tilla shfaqen bankat e klasifikuara si "Të tjera"[55] dhe ato me kapital shqiptar. Në pjesën më të madhe, bankat individuale ruajnë norma të mjaftueshmërisë së kapitalit në intervalin 14%-18%, megjithatë në pjesën e parë të vitit tre banka të sektorit bankar rezultuan me një normë mjaftueshmërie që shtrihej në intervalin 18%-20%.

Grafik 8.43 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas madhësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.44 Shpërndarja e aktiveve të sektorit sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.45 Koeficientët e ponderimit dhe madhësia e klasave kryesore të portofolit të kredisë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(102) Sektori bankar paraqet një ekspozim në rënie përsa i përket klasave të rrezikut të kredisë. Aktivet e ponderuara me rrezikun e kredisë ranë me rreth 1.9 miliardë lekë krahasuar me fundin e vitit 2016, duke arritur në nivelin 700 miliardë lekë. Kategoritë e kredisë që shënuan rënie lidhen me ekspozimet ndaj korporatave dhe kredive me probleme të ponderuara me një koeficient rreziku 100% (Grafik 8.45). Sipas grupeve të bankave, bankat e vogla paraqesin ekspozim të lartë për kredinë e siguruar me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme; bankat e mesme kanë ekspozim më të lartë për kredinë për korporata dhe për kredinë me probleme, ndërsa bankat e mëdha, përveç këtyre kategorive, mbeten të ekspozuara edhe ndaj kredisë për organet administrative dhe institucionet e mbikëqyrura. Në ndarjen sipas origjinës së kapitalit, vërehet që bankat me kapital shqiptar kanë ekspozim më të lartë për klasën "Kredi për korporata dhe kredi me probleme" (Grafik 8.46).

[55] *Në këtë grup përfshihen bankat me kapital turk, arab, kuvajtian dhe malajzian.*

Grafik 8.46 Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas madhësisë së aktivitetit dhe origjinës së kapitalit për qershor 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.47 Treguesi i levës financiare, në herë



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

(103) Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut kanë shënuar rënie, ndërsa ato për rrezikun operacional kanë mbetur të pandryshuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2017. Për periudhën, kërkesat për kapital për rrezikun e tregut shënuan vlerën 14.5 miliardë lekë, në rënie me 0.6 miliardë lekë ose 4.1%. Kërkesat për kapital për rrezikun operacional mbetën të pandryshuara. Këto të fundit zënë afërsisht 10.1% të totalit të aktiveve të peshuara me rrezik, ndërsa kërkesat për kapital për rrezikun e tregut vetëm 1.7%.

(104) Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i ulët i levës financiare, gjë që konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë të kapitalizimit. Treguesi i levës financiare[56] në qershor 2017 ishte 10.1 herë, nga 10.4 herë një vit më parë. Leva financiare në nivel bankash individuale nuk paraqet zhvendosje të rëndësishme.

[56] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksioner.*

9. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR, SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS[57]

(105) Ushtrimi i provës së rezistencës ka vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar kundrejt zhvillimeve ekonomike dhe financiare për periudhën e ardhshme dyvjeçare. Pavarësisht se rezultatet dëshmojnë se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm, ai paraqitet më i ekspozuar në rastin e skenarit të rënduar, ku dhe supozimet janë më ekstreme. Ndikimi i skenarëve në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit, evidenton nevojën për kapital shtesë në disa prej bankave individuale. Prova e rezistencës për situatën e likuiditetit mbështet vlerësimin për një gjendje të kënaqshme likuiditeti të sektorit bankar.

9.1 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË NDAJ GODITJEVE MAKROEKONOMIKE

(106) Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar dhe mjaftueshmërinë e kapitalit për periudhën 2017-2018. Vlerësimi i ndikimit të situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar përjashton mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës. Ushtrimi kryhet duke aplikuar tre skenarë: skenarin bazë; skenarin e moderuar dhe, atë të rënduar. Dy skenarët e fundit, kanë një probabilitet më të ulët ndodhjeje.

Grafik 9.1 Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

[57] *Prova e rezistencës nuk përfaqëson një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme, skenarët përmbajnë zhvillime negative dhe ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Megjithëse bankat nxiten të vlerësojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t'i konsiderojnë këta skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm përgjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër, skenarët nuk marrin në konsideratë veprimet që mund të kryejnë bankat dhe autoritetet për të forcuar në vazhdimësi situatën financiare dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve të bankave.*

(107) Skenari bazë supozon një rritje ekonomike pozitive deri në fund të vitit 2018 dhe në nivele relativisht të krahasueshme me vlerat faktike të T1-2017. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me nivele të qëndrueshme të kreditimit, mbështetur edhe nga përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2018. Performanca e portofolit të kredive me probleme ka vijuar të ndikohet qenësisht nga masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në kuadër të platformës për trajtimin e kredive me probleme.

(108) Në skenarin e moderuar supozohet një rritje ekonomike pozitive, por me ritëm më të ulët se në skenarin bazë; ndërsa, në skenarin e rënduar është supozuar një tkurrje e ekonomisë deri në fund të 2018-ës. Këto zhvillime, të kombinuara edhe me një nënçmim të kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritje të normave të interesit, si dhe dobësi të kreditimit deri në tkurrje, kanë ndikuar performancën e sektorit në terma të kapitalizimit të tij. Cilësia e portofolit në këta skenarë reflekton, krahas pastrimit të bilancit, edhe prurjet e reja të kredive me probleme. Si rezultat, raporti i kredive me probleme paraqitet i përkeqësuar deri në fund të vitit 2018 me përkatësisht deri në 17.5 pp (skenari i moderuar) dhe 36.5 pp (skenari i rënduar) ndaj nivelit të skenarit bazë. Skenarët e përkeqësuar, në vijim të uljes së cilësisë së kredisë, supozojnë edhe goditje në terma të rrezikut të tregut: rrezikut të normës së interesit, rrezikut të riçmimit të letrave me vlerë, rrezikut të kursit të këmbimit, si dhe atij operacional.

(109) Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:

a. **në skenarin bazë,** norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit shënon 16.1% në fund të vitit 2017 dhe 16.6% në fund të vitit 2018, në vijim të ritmit më të lartë rritës të kredisë dhe përmirësimit të cilësisë së saj, si edhe falë ecurisë më të favorshme të kursit të këmbimit. Edhe zhvillimet sipas grupeve bankare dëshmojnë për një qëndrueshmëri dhe nivel kapitalizimi të tyre ndjeshëm mbi minimumin rregullator.

b. **në skenarin e moderuar,** RMK-ja e sektorit arrin në nivelin 13.2% në fund të vitit 2017 dhe 12.8% në fund të vitit 2018. Kjo normë ndikohet nga supozimet për një ritëm më të ulët rritjeje të aktivitetit ekonomik; ndalim të kreditimit të ekonomisë; rritje të normave të interesit; si edhe nënçmim i monedhës vendase. Pavarësisht ruajtjes së nivelit të kapitalizimit në nivel sektori, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali në 6 prej tyre, të cilat përbëjnë rreth 35% të aktiveve të sektorit. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë arrijnë deri në 15.2 miliardë lekë deri në fund të vitit 2018.

c. **në skenarin e rënduar,** RMK-ja e sektorit ulet edhe më tej, në nivelin 10.1% në fund të 2018-ës, nisur nga supozimet edhe më të rënduara që përfshin skenari. Në këtë skenar, numri i bankave që bie në nënkapitalizim shkon në dhjetë dhe ato zënë rreth gjysmën e aktiveve

të sektorit. Zhvillimet makroekonomike ekstreme që përmban skenari, ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së kredisë, në nivelin e humbjeve në portofolin e letrave me vlerë dhe në rritjen e ekspozimit ndaj rrezikut të tregut dhe atij operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë rezultojnë ndjeshëm më të larta se në skenarin e moderuar.

Për t'i vendosur vlerat e kërkuara të kapitalit shtesë në një kontekst real, përmendim që gjatë periudhës kapitali i paguar i sektorit bankar është rritur me rreth 5 miliardë lekë ose rreth dy herë me shumë se rritja kapitalit në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 9.2 Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

9.2 PROVA E REZISTENCËS SË LIKUIDITETIT

(110) **Prova e rezistencës së likuiditetit ka për qëllim të vlerësojë aftësinë e bankave individuale dhe sektorit bankar në përgjithësi për t'iu bërë ballë goditjeve ekstreme por të mundshme në financimin e veprimtarisë së tyre.** Këto prova synojnë të evidentojnë dobësi apo mangësi të sektorit dhe bankave të veçanta në monedha, instrumente dhe horizonte të caktuara kohore; të vlerësojnë gatishmërinë e bankave për të përballuar skenare ekstreme të mungesës së likuiditetit; si edhe të ndihmojnë autoritetin mbikëqyrës për ndërmarrjen e politikave të posaçme që adresojnë menaxhimin e likuiditetit, duke përfshirë masat që synojnë uljen e ekspozimeve ose krijimin e rezervave specifike.

(111) **Analiza në këtë rast është ndërtuar në bazë të strukturës së likuiditetit të sektorit në maj 2017.** Burimi i të dhënave bazohet në të dhënat individuale të bankave për flukset granulare të parasë të gjeneruara nga aktivet dhe detyrimet e klasifikuara sipas strukturës së maturimit. Skenarët e ndryshëm

supozojnë disa goditje të tërheqjes së papritur të depozitave dhe vlerësojnë përshtatshmërinë e aktiveve likuide të zgjeruara në dispozicion për financimin e tyre. Më konkretisht:

(i) Ushtrimi supozon se bankat do të përballojnë tërheqjen e theksuar të depozitave të tyre, nëpërmjet shitjes vetëm të aktiveve likuide të zgjeruara (pa kërkuar likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë);

(ii) Shitja e investimeve në tituj është bërë me një marzh reduktues (*haircut*) të vlerës së tyre prej 10% dhe 20%. Banka konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara tkurren deri në nivelin ku ka nevojë për likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

Banka konsiderohet se dështon në ushtrimin e provës së rezistencës vetëm nëse aktivet likuide të zgjeruara[58], që shiten me marzhe reduktuese të përcaktuara nga ushtrimi, janë të pamjaftueshme dhe nevojitet likuiditet shtesë nga Banka e Shqipërisë në formën e "kredisë për mbështetje me likuiditet".

(112) Rezultatet e ushtrimit tregojnë se sektori bankar e kalon përgjithësisht me sukses provën e rezistencës së likuiditetit. Skenari që supozon përdorimin e aktiveve likuide të zgjeruara për të mbyllur hendekun e likuiditetit, tregon se për monedhën Lek ka një bankë që nuk arrin të mbyllë hendekun për 6 nga 8 shportat e maturimit dhe dy banka që nuk arrijnë ta mbyllin hendekun për njërin prej maturiteteve; për monedhën Euro hendeku vijon të mbetet negativ për dy banka për dy shportat e para të maturimit, ndërsa për monedhën Usd hendeku mbetet negativ për një bankë për të gjitha shportat përtej shportës së parë (deri në 1 ditë).

(113) Rezultatet e ushtrimit tregojnë se sektori bankar e kalon përgjithësisht me sukses provën e rezistencës së likuiditetit. Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, rezultatet për hendekun e thjeshtë të likuiditetit[59] tregojnë një dobësim të situatës në monedhat Euro dhe USD dhe një situatë pothuajse të njëjtë për monedhën Lek.

(114) Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, duke gjykuar nga numri i bankave që nuk e kalojnë provën, vërehet një përmirësim i situatës për monedhat Lek dhe Usd dhe një situatë e njëjtë për monedhën Euro. Në rastin e Lekut, numri maksimal i bankave që nuk arrijnë të mbyllin hendekun negativ të likuiditetit edhe pas shitjes së aktiveve likuide të zgjeruara, është 2 dhe më i ulët në krahasim me 3-4 banka që vazhdonin të regjistronin hendek negativ në ushtrimin e gjashtëmujorit të kaluar, gjë që reflekton rritje të stokut të aktiveve likuide në monedhën Lek. Për dy monedhat e tjera, pas shitjes së aktiveve

[58] *Në ndryshim nga koncepti i aktiveve likuide sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, që kufizon afatin e maturimit të titujve që përfshihen si "aktive likuide", në këtë koncept, për qëllime të këtij ushtrimi, përfshihet i gjithë portofoli i titujve.*

[59] *Përpara shitjes së aktiveve likuide.*

likuide rezulton se në sistem mbetet vetëm një bankë që vijon të regjistrojë hendek negativ në monedhën përkatëse. Për të tri monedhat, madhësia e hendekut për shportat me hendekun më të madh në raport me aktivet e sektorit në atë monedhë, është mjaft e ulët (0.2% për Lekun, 0.3% për Euron dhe 0.4% për USD). Ushtrimi tregon se në sektorin bankar nuk ka banka që përballen me vështirësi likuiditeti në dy ose tre monedha njëherësh dhe se sektori bankar ka forcuar kapacitetet kundërpeshuese në krahasim me një gjashtëmujor më parë.

(115) Në përfundim, vlerësohet se bankat kanë një elasticitet të mirë ndaj goditjeve të likuiditetit. Gjithsesi, niveli i ulët i diversifikimit në rezervat e likuiditetit, që përbëhen kryesisht nga tituj të borxhit qeveritar, nxjerr në pah nevojën për thellimin e tregut dhe rritjen e likuiditetit për këto instrumente.